

Hafiz Ali Ulqinaku
Hafiz Abdullah Zemblaku

MEVLUDI SHERIF

(I PËRPUNUAR)

DHE

ARGUMENTET PËR TË

Përgatit Haxhi Ymer Aga

Tiranë, 2013

Bismilahirr-Rrahmani Rrahim

PARATHËNIE

Mevludi lindja dhe jeta e Profetit tonë hazretit Muhammedit a.s.nuk është një poezi sipas qefit të ndonjë dijetari. Lindja dhe jeta e Pejgaberit a.s.është e bazuar në ajetet e Kur'anit në hadithe fjalët e tij dhe në historinë Islame sipas tregimeve të shokëve dhe të fisit të tij.Ky mevlud që keni në dorë është mevludi që ka përkthyer në gjuhën shqipe Hafiz Ali Ulqinaku në vitin.1879 Allahu ia shpërbleftë.Që atëherë ka kaluar një kohë e gjatë dhe gjuha shqipe është përmirësuar dhe zgjeruar shumë. Shumë fjalë që i ka përdorur në atë kohë gjatë përkthimit të Mevludit Hafiz Ali Ulqinaku nuk kuptohen nga të gjithë njerëzit mbasi janë në gjuhën arabe e turke.Nga ky shkak Mevludi nuk kuptohet mirë nga dëgjuesit e kështu nuk bëhet tërheqës për ata.Për tu ardhur në ndihmë njerëzve që ta kuptojnë sa më mirë Mevludin,unë e përpunova atë por duke i qëndruar besnik origjinalit të Hafiz Ali Ulqinakut.Veç fjalëve arabisht e turqisht që i kam hequr dhe i kam zëvendësuar me fjalë shqipe e kam pastruar Mevludin nga disa fjalë edhe fjali që formonin keq kuptim në gjuhën shqipe sipas ligjit Islam.Në disa raste disa fjalë e shprehje formonin kufër e shirk në gjuhën shqipe.Lejen për ta korigjuar ndonjë gabim në librin e Mevludit e kam nga vetë autori Hafiz Ali Ulqinaku i cili në parathënien e librit ai thotë: “Kushdo që ta shikojë ndonjë hata-(gabim të madh) le ta ndreqi-(ta korigjoi) atij njëri i bëj rixha=(i lutem-i themi)”. Edhe unë duke pasur qëllimin e pastër për ti shërbyer fesë Islame e mora për sipër këtë gjë dhe me dëshirën e Allahut xh.sh.inshaallah ia kam arritur qëllimit.Në libër kam treguar dhe argumentet e dijetarëve Islam për Mevludin.Ve ma teufiki il-la bil-lah. Mbarëvajtjen e shpresoj prej Allahut (xh.sh). Në këtë libër kam futur edhe Mevludin {të përmbledhur} prej Hafiz Abdullah Zëmbllakut, Korçë.

E përpunoi Mevludin: Haxhi Ymer Aga.Imam xhamie-Farkë-Tiranë.Viti-2013

NË FILLIM, NË MES DHE NË FUND, KËNDOJMË AJETE
NGA KURANI, KU PËRMENDET PEJGAMBERI A.S. SI:

SURE ALI IMRAN AJ.144, وَمَا مُحَمَّدٌ إِلَّا رَسُولٌ قَدْ خَلَتْ مِنْ قَبْلِهِ
الرُّسُلُ أَفَلَيْسَ مَا تَأْتِيهِمْ آيَاتُ الْكُتُبِ وَالرُّسُلِ
أَعْقَبِكُمْ وَمَنْ يُنْقَلِبْ عَلَيْنَ عَيْتِيهِ فَلَن
تُخَذَّ اللَّهُ مِنْهُم مِّنْ أُمَّةٍ قَدْ خَلَتْ مِنْ قَبْلِهِ
أَلَمْ يَكُن لَّهُمْ لِحُكْمِي فَكُنَّ حَتَّىٰ يَحْكُمَ اللَّهُ
بَيْنَهُمْ وَهُوَ مُخْتَصِمٌ لَا يُشْرِكُ بِاللَّهِ

SURE AHZAB AJ.40 E 56,

إِنَّ اللَّهَ وَمَلَائِكَتَهُ يُصَلُّونَ عَلَى النَّبِيِّ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا صَلُّوا عَلَيْهِ
وَسَلِّمُوا تَسْلِيمًا

مَا كَانَ مُحَمَّدٌ أَبَا أَحَدٍ مِّن رِّجَالِكُمْ وَلَكِن
رَّسُولَ اللَّهِ وَخَاتَمَ النَّبِيِّينَ وَكَانَ اللَّهُ بِكُلِّ
شَيْءٍ عَلِيمًا

S. MUHAMED AJ.2. وَالَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ وَآمَنُوا
بِمَا نَزَّلَ عَلَيْنَ مُحَمَّدٍ وَهُوَ الْحَقُّ مِنْ رَبِّهِمْ
كَفَرْنَا عَنْهُمْ سَيِّئَاتِهِمْ وَأَصْلَحْنَا بِأَلْفِهِمْ

S. FETH AJ.29, مُحَمَّدٌ رَسُولُ اللَّهِ وَالَّذِينَ مَعَهُ أُولُوا الْقُرْبَىٰ رَحِمَةً مِّنْ اللَّهِ وَمَنْ يَتَّبِعِ
آيَاتِهِمْ سَتَرْنَا لَهُمْ جَمِيعًا مِمَّا كَفَرُوا وَالَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ
سَنَجْعَلْ لَهُمْ مَخْرَجًا وَسَنَخْرِجُهُمْ مِّنْ أَرْضِهِمْ حَسْبُ الْكَافِرِينَ
الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ لَنُدْخِلَنَّهُمْ
الْجَنَّاتِ الَّتِي فِيهَا جَارُونَ لَنُزِيلُ فِيهَا
مِنْ ثَمَرَاتٍ لَّيْسَ فِيهَا مِنْ أَسْفَلٍ شَيْءٌ
لَّهُمْ فِيهَا أزْوَاجٌ مُّطَهَّرَةٌ وَهُمْ فِيهَا
قَائِمُونَ

MEVLUDI

LINDJA E PEJGAMBERIT TONË A.S.

Bismilahi emrin e Zotit ta thomë
Borxhë e kemi në çdo punë kur ta fillojmë
Emrin e All-llahut kushdo që ta thotë
Kollaj i bahen gjitha punët kur ta thotë.
Të ishte emri i Zotit para në çdo punë
Përfundonte pa mbet mangut ajo punë
Për çdo frymë që të marrim Allah duke thon
Me këtë emër të gjitha punët bahen tamam
Ai njeri që me gjithë shpirt All-llah të thotë
Gjynahet i shkunden e i bin për tokë.
Emrin All-llah i pastër ai rob që e thotë
Gjithë dëshirat i plotsohen atij që e thotë
Me gjithë shpirtë emrin e Zotit me e përmend
Duke qa me lot All-llah gjithmonë të them
Që të bëj mëshir për neve ai All-llah
Dhe gjynahet të na i fali ai All-llah
Zoti një është dhe për Të dyshim nuk ka
Vetëm të padijshmit e mohojnë këtë gja
Gjithë dynjaja nuk ka qenë Ai ka qenë
E ka kriju dhe e ka ba për të qenë
Nuk ka pasur xhind e njerëz e as melek
Diell e Han dhe qiell e tokë e asnjë send
Të gjithë këta All-llahu vetë i ka kriju
Gjithë sa janë All-llahun e kanë vërtetu

Zoti madhrushëm nuk ha edhe nuk pi
Edhe gjumë Ai kurrë nuk ka as shokë e fëmij
Kushdo që i lutet All-llahut gjithmonë
Ne se shohim Ai na sheh çfarë punojmë
Zotin do ta shohim ne në Ahiret
Zoti është Ai që askujtë nuk i përngjet
Fjalën për ta zgjatur ma nevoj nuk ka
Zoti një është dhe askënd ortak nuk ka
S'është e mundur deri në kijamet me u tregu
Edhe sikur deti të bëhet bojë me shkru
Halli jonë si ka me qenë në Ahiret
Për gjynahçarët vetëm Zoti bëftë rahmet
Edhe na bëftë Pejgamberi shefaat
Gjithmonë me shpirt ti çojmë atij salavat

Salavat 3 herë

All-llahum-me sal-li ala sej-jidina
Muham-medi-nin nebij-jun umijin
Ve ala alihi ve sahabihi ve sel-lim

O vëllezër më ndigjoni çfarë ju them
Një porosi po ju le ta mbani mend
Këtë porosi kush të dojë për ta mbajtë
Si trëndafil era shpirtit të atij i ardhhtë
Zoti e faltë në Ahiret dhe në dynja
Atë që të më kujtojë mua me një dua

Kushdo që të gjindet këtu i bëj rixha
Shpirtit tim të ia këndoje një Fatiha

Lil-lahi el Fatiha

Qysh kur Zoti e zbriti Ademin në tokë
Shum e rregulloi dhe e hijeshoi këtë botë
Hazreti Ademin melekët kur e panë
Shumë e deshën dhe të gjithë përulje i ban
Por shejtani nuk pranoi me iu përul
Zoti e mallkoi atë në atë minut
Tha shejtani mua prej zjarrit më ke kriju
Ky prej balte kurrë nuk është më i mirë se unë
U krenu ai në atë çastë e gjet belan
Shumë u pendu por atij dobi si ban
Kushdo që të krenohet veten të madh e mban
Zoti atë rob si shejtanin e mallkon
Veç shejtanit të gjithë melekët nderim i banë
Hazreti Ademit të gjithë kur e panë
Zoti atij nurin e Muhamedit ia dha
Dije ky nur është i mikut tim i tha
Mbas atij tek hazreti Havaja shkoi
Disa vjet nuri në ballin e asaj qëndroi
Lindi hazreti Shiti nuri ndërroi vend
Edhe në ballë të tij disa vjet shkoi e ndejt
Dhe tek Ibrahimimi e te Ismaili ndejt
Fjala zgjatet një nga një me i përmend

Gjithë pejgamberët një nga një nuri i kërkoi
Erdhë Resulallahi te Ai nuri shkoi
 Pejgamberëvet të gjithë në ballë nuri ju shkoi
 Vajt te Ai Resul nuri aty qëndroi
Sa do që jemi të mbushur me gjynah
Insha-Allah na ban shefa-at Ai Mustafa
 Halli jonë si ka me qenë në Ahiret
 Në qoftë se nuk na pranon Ai për ymet
Kush të dojë në Ahiret me gjetë shefa-at
Pejgamberit gjithmonë ti çojë salavat

Salavat

All-llahume sal-li ala Muhamed
Neb-bijun resulun ismuhu Ahmed
All-llahum-me sal-li ael Mustafa
Neb-bij-jun Resulun ve bahru safa
All-llahum –me sal li ael Hashimi
Neb-bij-jun Resulun Ebul Kasimij

Amineja nana e Muham-med Mustafas
Prej asaj erdhi Ai dielli i gjithë dynjas
 Tek ajo u dukën shumë shenja si dëshmi
 Që prej asaj kishte me lindë Ai nebij
Kur prej Allahit shtatëzanë ajo u ba
Koha ja arriti me ardhë në dynja
 U afruan shumë javë e dit u ban tamam
 Dhe Resultit shum mrekulli para ju panë

Lindi në muaj të Rebi-ul-Evelit ishte natë
E hana mbrëma ishte e dymbëdhjeta natë
Tha e ëma shumë mrrekulli pash atë nat
Porsi dielli pashë një nur që ndriste fort
U çudita prej shtëpije doli një nur
Deri në qiell gjithë dynjaja u mbush me nur
Edhe lart në ajër u shtru një dyshek
Ishte prej mëndafshi e shtroi një melek
Tre flamuj prej nuri i pashë që u ngulën vetë
Gjithë secili u valviste në vend të vet
Njëri ku lind tjetri u ngul ku perëndo
Njëri mbi kulmin e Qabes aty qëndroi
E kuptova që atij Muham-med Mustafa
I erdhë koha për të ardhur në dynja
Erdhën melekët prej qiellit të rreshtu
Por si Qaben shtëpinë time e kanë vizitu
Edhe muri i shtëpisë u ça u çudita unë
Prej xheneti tri hyri erdhën te unë
Rreth e rreth meje u sollën duke dhan
Lajme të gëzushme për Muhamed Mustafan
Ky resul si djali jot hyritë më thanë
Ndonjë nane Zoti askujt nuk ia ka dhan
Ky fatmadh lum por si ti o moj fatbardhë
Që prej trupit tandë ky Resul për me ardhë
Është një Resulë që ka me i thirrë njerëzit në iman
Ky që po lind të mirën prej të keqes e ndan
Vlerat e tij një nga një ata mi than
Edhe atij nurit shum nderim i banë

Amines koha i erdhi e u ba tamam
Ajo për të lindë Muhamed Mustafan
 Kishim etje tha, mu tha goja kishim nxehtësi
 Më sollën një gotë plot me sherbet për ta pi
Ma i ftohët se bora e ma i bardhë me të vërtetë
Ma i ambël se sheqeri kishte qenë
 Kur e piva trupi im u mbush me nur
 S'munda ta dalloj trupin tim nga ky nur
Erdhë një zog me krahë të bardhë e më shtërngoi
Kraharorin tim dhe mua ai më ndihmoi
 U driçua jeta kur lindi Ai Resul
 Qiell e tokë në atë orë u mbush me nur
Kush të dojë nga xhehenemi të shpëtoi
Të ndjekë rrugën e Tij dhe salavat ti çoi

Salavat 3 herë

All-llahum-me sal-li ala sej-jidina
Muham-medinin-nebij-jun umijin
Ve ala alihi ve sahabihi ve-sel-lim

Ajet Kurani

Eudhu bil-lahi minesh-shejtanirr-rraxhim
Bismil-lahirr Rrahmanirr- Rrahim

Ja ej-ju hen-nebij-ju in-na erselnake
shahiden ve mubeshiren ve nedhira

ve daijen il-lall-llahi bi idhnihi
ve siraxhen munira ve besh-shiril
muëminine bi en-ne lehum minall-llahi
fad-len kebira. **Sadakall-llahul aadhijm.**

Erdhi në dynja në atë kohë që u besu
Gjithë çka ishte i krijuar u gëzu
 Shpirt e pa shpirtë gjithë me za thirrën ata
 Gjithë i thoshin mirë se erdhe o Mustafa
Mirë se erdhe fat i madh lum porsi Ti
Kësaj grade nuk ia ka arrit askush si Ti
 Mirë se erdhe xheneti sot u stolis
 Mirë se erdhe o më i miri i gjithë njerëzis
Mirë se erdhe o ilaçi i zemravet tona
Mirë se erdhe o ndriçimi i syvet tonë
 Mirë se erdhe o gëzim i shpirtave tonë
 Mirë se erdhe je mëshirë për gjithë dynjanë
Mirë se erdhe o dielli i gjithë dynjas
Mirë se erdhe ilaçi i zemrës së fukaras
 Mirë se erdhe ymeti jotë që të nderon
 Mirë se erdhe Zoti vuajtjet ia lehtëson
Mirë se erdhe ke të duash Ti për ymet
Mirë se erdhe shefaat ai ka me gjetë
 Mirë se erdhe i ban shefaat ym-metit tand
 Mirë se erdhe prej xhehenemit i largon
Mirë se erdhe ymeti jot duke qa me lot
Borxhë e kemi ti çojmë atij salavat

Salavat

Salatul-llah salamullah alejke ja Resulallah
Salatull-llah salamullah alejke ja Habiballah
Salatull-llah salamullah alejke ja Nebijallah
Salatull-llah salamullah alejke ja Rahmete lil alemijn

Kur lindi Resuli u gazmuan gurë e dru
Prej bukuris Tij gjithë dynjaja u hijeshu
Njëri tjetrit gjithë melekët këtë lajm i dhan
Sonte lindi Resuli që fenë e plotëson
Kur e pa e ëma u çudit prej Atij
Mendja prej kokës i doli e i erdhë përssi
Kur shikon si sheh me sy ata hyri
Edhe të birin nuk e pa ku shkoi se di
Mendoj se hyritë ja morën asaj fëmij
Shumë u dëshpëru ajo për atë Emin
Rreth e qarkë shtëpisë e kërkoi duke shiku
Kur shikon në një qoshe shtëpije kishte shku
Ishte drejtu karshi Qabes Ai Resul
Edhe kokën në tokë e kishte vu Ai Resul
Bante shenjë me gishtin lartë Ai Mustafa
Edhe thoshte la ilahe il-lall-llah
Tue i ba sexhde Zotit me ballin në tokë
Lunte buzët nuk e mora vesh çfarë thotë
Vuna veshin në gojë të Tij për ta ndigju
Se çfar thoshte mbasandaj e kam kuptu
Thoshte ja All-llah Ti që më ke kriju

Të lutem ym-metin tim për ta shpëtua
Për ymetin iu luste Zotit ja Rab-bi
Thoshte gjithmonë ym-meti va ym-meti
Ai është lut për njerëzit duke qenë fëmij
Ti duke qenë plak e len rrugën e Tij
Ju luste Zotit ai Muham-med Mustafa
Ti shpëtojë në Ahiret dhe në Dynja
Kush të dojë prej xhehenemit të shpëtojë
Të ndjekë rrugën e Tij dhe salavat ti çojë

Salavat

Es-salatu ve selamu alejke ja Resulallah
Es-salatu ve selamu alejke ja Habiballah
Es-salatu ve selamu alejke ja Nebij-jallah
Es-salatu ve selamu alejke ja Rahmete lil aalemin

Kur lindi Resuli banorët e Mekës kanë tregu
Se Qaben atë natë gjithë e panë duke u rrotullu
Sexhde bani Qabja atë natë gjithë e panë
Edhe gurët asaj në tokë nuk i ranë
Edhe qoshja qoshes i jepte selam
Sonte lindi Resulallahi ata than
Prej Qabes doli një za thirri e tha
Sonte ka lindë Dielli i gjithë dynjas
Kokën zbulu edhe zbathur do të vinë rreshtu
Ymeti i Tij ka për të ardhë me më vizitu
Dhe prej idhujsh do të më pastrojë Ai Resul
Të vërtetën do ta thotë Ai Resul

Dhe shejtanët të gjithë sa ishin janë zëmru
 Thirri një za prej qiellit me i largu
 Gjithë çka ishte i mbyllur e i lidhë u lëshu
 Zemra gjithkujt iu kënaq e iu gëzu
 Pejgamberi dyzet vjeç kur i plotësoi
 Zoti pastaj pejgamber atë e dërgoi
 Xhebraili me urdhër të Zotit te ai shkoi
 Me i zbrit Kur`anin Atij ia filloi
 Zoti i madhërushëm ashtu e kishte caktu
 Për njëzet e tre vjet Kuranin me e plotësu
 Pejgamberi edhe shumë mrrekulli tregoi
 Ishin të qarta të gjitha populli i shikoi
 Hije nuk i bante në tokë trupi Atij
 Prej shkëlqimit që kishte nga nuri Ai
 Edhe sipër kokës i rrinte një re
 Hije i bënte kudo që shkonte me Te
 Kur i lunte buzët e Tij banin shkëlqim
 Por si Hana që i jep natës ndriçim
 Prej shkëlqimit të dhambëvet të Tij pors i inxhi
 Gjylpanën natën e gjente plak edhe i ri
 Edhe kur ia lunte era flokët Atij
 I kënaqte me erë të mirë të gjithë Ai
 Kur djersiste Resuli ashtu si çdo njeri
 Si trandafilja i vinte era djersës Atij
 Dhe prej nurit të trupit të Resultit beku
 Natën ecnin rrugës të rij e të moshu
 Mbollin një hurmë me dorë të vet ai Mustafa
 Mbini e u rrit për një orë kokrra i dha

Mrrekullitë e Resulit janë shumë me i numëru
Mbi të gjithë All-llahu atë e ka lavdëru
Mrrekulli më e madhe për ne sot është Kurani
Që me të krenohet gjithmon muslimani
Mevludin e Resulit duhet ta këndojmë
Si Resuli dhe ne duhet të veprojmë
Kush të dojë nga xhehenemi të shpëtoi
Të ndjekë rrugën e Tij dhe salavat ti çoi

Salavat 3 herë

All-llahu-me sal-li ala sej-jidina
Muhamedin neb-bij-jun umijin
Ve ala aalihi ve sahabihi ves-sel-lim

Miraxhi i Pejgamberit a. s.

Ndigjoni si ka shku në qiellna Resuli beku
Në qoftë se keni merak shumë për të ndigju
Ditë e hënë në mbrëmje që ta dini ju
Nata e Kadrit ajo natë kishte qëllu
Pejgamberi nga shtëpia kishte dalë
Në shtëpi të Ym-mehanit kishte ardhë
Pejgamberi te shoku i Tij atë natë qëlloi
Xhebrailin në xhenet Zoti e çoi
Merr një kurorë të qëndisur i tha e një gjerdan
Edhe merr ti një burak që të jet me famë.

I dashuri im të vijë shpejt e të shikojë,
 Të gjithë qiellnat një nga ai ti kalojë
 Xhebraili shkoi në xhen-net si ju tha
 Duke shetit dyzetëmijë burakë i pa
 Sheh një burak që lotët i rridhshin si shi
 Që nuk hante edhe nuk kishte fuqi
 Sytë i rridhshin gjak burakut duke qa
 Prej merakut mushkërit i ishin tha
 Xhebraili i tha burakut: Përse qa
 Si e ke hallin ti kështu që qenke ba
 Shokët e tu hanë e pinë e gëzim kanë
 Ti përse rënkon e çfar do ti që po qan
 Tha buraku dyzetmijë vjetë ma përpara
 Jam ba merak nuk du të flej e nuk du të ha
 Ndigjova një za se nga thirri unë se di
 Që atëherë nuk di ku jam e as nuk di si rri
 O Muhamed duke thirr e kam ndigju
 Mbas këtij emri jam ba merak e jam përvëlu
 Zemra ime prej merakut mua mu shkri
 Halli im si ka me qenë as unë se di
 Sado që në Xhenet më sheh mua që rri
 Zjarrin e Xhehenemit po e shikoj me sy
 Në qoftë se nuk takohem unë me atë Nebij
 Shpirtin edhe trupin unë kam për ta shkri
 Xhebraili i tha atij o burak
 Zoti ta plotësoj dëshirën mos u ban merak
 Kushdo që të bahet merakli për ndonjë gja
 Pa dyshim Zoti e takon me atë që do

Xhebraili eja shkojmë atij i tha
Zoti zemrës tande ilaçin ia dha
Kush të dojë në Ahiret me gjet shefaat
Pejgamberit gjithmon ti çojë salavat

Salavatet

All-llahum-me sal-li ala Muhamed
Nebi-bijun Resulun ismuhu Ahmed
All-llahum-me sal-li alel Mustafa
Neb-bij-jun Resulun ve bahru safa
All-llahum-me sal-li alel Hashimij
Neb-bij-jun Resulun e bul kasimij

Xhebraili mori burakun në atë çast
Dhe ia solli shpejtë Muham-med Mustafas
Zoti ty i tha të çon selam o Muham-med
Ai tha do t'ia mbaroj çdo hall që të ketë
Zoti mua më ka urdhëru o Mustafa
Ndër qiellna me u ngrit Zotin me e pa
Do të shikosh ti sonte gjithçka është kriju
Bukuria e Zotit ka për tu tregu
U dha lajmi sonte shkon Resuli i beku
Lart në qiellna Ai ngrihet me shiku
Tetë dyrët e Xhen-netit janë hapur sot
Dhe rahmeti Zotit sonte bie në tokë
Eja shkojmë se në pritje po të presin ty
Atje gjenden të gjith shokët që do ti

Një burak unë prej Xheneti ta kam sjell
Zoti të thërret me shku o Muham-med
Menjëherë prej vendit u ngrit Ai i beku
Dhe kurorën me shum respekt në kokë e vu
I hip burakut ai Muham-med Mustafa
Xhebraili atij i prini përpara
Sa i mbyll e i hap sytë Resuli atje shkoi
Në Kudsi sherifë arriti edhe e shikoi
Të gjithë shpirtrat e pejgamberëvet kur e panë
Në pritje i dolën dhe të gjithë nderim i banë
Ai doli para tyre e u ba imam
Jan rreshtu të gjithë pas Pejgamberit ton
Fali dy rekat namaz Resuli me ata
Zoti madhrushëm e kishte caktu atë gja
Mbasandaj Resuli aty nuk qëndroi
Lart në qiellna u ngrit dhe ata i vizitoi
Në çdo vend gjana të çuditëshme Ai shikoi
Deri sa në Sidrej Mynteha Ai shkoi
Aty rrinte Xhebraili ai melek
Qysh kur Zoti kishte kriju nëntë planet
Xhebraili u ndal aty edhe zu vend
Zoti tha më ka urdhëru këtu me ndejt
Unë ma tutje nuk kam leje me kalu
Edhe rrugët andej nuk i di me shku
Xhebraili i tha Resultit më ndigjo
Zoti vetëm nuk do të lejë mos u mendo
Zoti për njeriun ka kriju çdo gja
Ti je më i dashur nga Zoti mbi të gjithë ata

Zoti madhrushëm ka kriju nëntë planet
Xhen-net hyri edhe njerëz dhe melek
Deri këtu unë për të ardhë e di tamam
Ma përtej për të kalu leje nuk kam
Kështu o Resulë; Zoti më ka urdhëru
Mos me i hap krahët andej mos me kalu
Sa një zerre unë me kalu ma përpara
Fund e krye digjem unë o Mustafa
Ka shumë kohë dëshira vjen duke mu shtu
Edhe unë u dogja andej për të kalu
Xhebraili atij i tha o Mustafa
Rrimë këtu se me kalu leje nuk ka
Ne nuk ishim dhe Zoti neve na krijoi
Pejgamber për gjithë botën ty të dërgoi
Zoti ka dërgu një Pejgamber për ne
Që përpara askush se ka pas atë
Kush të ketë merak dhe ta dojë me të vërtet
Zoti nuk e djeg atë rob në Xhehenem
Cili do që Pejgamberin nuk e do
Zoti Xhen-netin atij haram ia ban
Ai njeri që për Pejgamberin nuk ka dashni
Nuk ka shpresë ai kurrë me pa xhenet me sy
Mos e mendo një njeri që të kesh merak
Shpirtin me dhan për të është një gjë e pakë
Kush e do Resulallahin me të vërtet
Kokën me dhan për të nuk është as një send
Kush të dojë në ahiret me gjet shefaat
Pejgamberit gjithmon ti çojë salavat

Salavat

Salatullah, selamullah alejke ja Resulallah
Salatullah, selamullah alejke ja Habiballah
Salatullah, selamullah alejke ja Nebij-jallah
Salatullah selamullah alejke-ja Rahmete lilalemijn.

Duke fol me Xhebrailin Profeti jonë
Erdhë një melek dhe atyre ju dha selam
 Ai e mori Pejgamberin mbasandaj
 Prej Sidreje ai solli Mustafan
Engjëjt në qiellë lavdrim Zotit duke i ba
Gjithë secili me një mynyr Resuli i pa
 Disa el-hamdulilah disa sub-hanallah
 Disa thoshin la i la il-lallah
Disa në këmbë i rrishin Zotit me përulsi
Disa gjithmon në sexhde i rrishin Atij
 Disa e lavdronin Zotin që i ka kriju
 Disa prej dashnis ishin ba si të mbaru
Banorët e qiellit i dolën para me e përshtëndet
Pejgamberin e nderuan e i ban respekt
 Mirë se erdhe o Muhamed Mustafa
 Një nga një i thoshin ja Resulallah
Miraxhin të gjithë një nga një Atij ia urun
Dhe kurorën e lavdis gjith ia urun
 Kësaj grade si ti nuk ia ka arrit as'kush
 Dhe mbas teje nuk ka me ia arrit kërkush

Gjithçka ishte në qiell Resuli i shikoi
 Më në fund para Allahut ai qëndroi
 Gjithë lavdrimet falja e lutja i tha janë për Ty
 Kështu e përshëndeti Zotin ai Nebij
 Selami dhe mëshira ime janë për Ty
 Zoti i madhrueshëm pastaj i tha Atij
 Selami dhe mëshira jote ai i tha o Zot
 Qoftë për gjithë njerzit e mirë që janë në botë
 Bisedoi me Zotin ai Resulallah
 Zoti ka folur me të dyshim nuk ka
 Mir se erdhe o i dashuri im Zoti i tha
 Unë jam Ai që ke dashur ti Zoti i tha
 Ditë e natë ti gjithmonë u lutshe me përkushtim
 Ah sikur ta shikojsha një herë unë Zotin tim
 O i dashuri im Zoti atij i tha
 Për gjithë njerëzit fenerë dritës të kam ba
 Çdo hall që të keshë Unë ty atë ta mbaroj
 Dhe një halli njëmijë dermane i baj
 Tha Muham-med Mustafai me nderim
 Bujaria jote o Zot nuk ka mbarim
 Ymeti im i dobët do ta ketë vështir
 Veç Madhnia jote për ato bëftë mëshir
 Natë e ditë ymeti im gjynahe duke ba
 Frikë e kam se në Xhehenem ai ka me ra
 O All-llah të lutem ky është halli im
 Ke Ti i siguruar qoftë ym-meti im
 Nga All-llahu thirri një za e u ndigju
 O Muhamed lutja jote u pranu

Ke të duash ti për ymet ai, do të shpëtoi
 O Muhamed lutjet tuaja unë i pranoj
 O i dashur: ymetit tand Unë i kam tregu
 Në xhenet ato Unë kam për ti dërgu
 O Resuli im më ndigjo çfar të them
 Kjo që deshe ti për Mua s'është ndonji send
 Unë të dashur o Resul ty të kam ba
 Pa dyshim ta kam pranu këtë dua
 Nurin Tim pasqyr ja kam ba syvet tu
 Emrin Tim me emrin tand e kam afru
 O Muhamed i tha Zoti unë mir e di
 Bukurinë time duke shiku nuk ngopesh ti
 Shko e thirri ti në besim njerëzit e mi
 Kush të dojë në Xhenet të më shikojë me sy
 Me urdhër të Zotit ka zbrit në tokë ai Resul
 Në shtëpi të Ym-mehanit ai drejtë është ul
 Çfar i ndodhi Pejgamberit e çfar shikoi
 Porsa erdhi të gjithë shokëvet ju tregoi
 Edhe shokët tek Resuli u afrun
 Dhe miraxhin gjithë një nga një ia urun
 Ne të gjithë të besojmë Ty o i dashuri jonë
 O ndriçimi i zemrave e i syvet tonë
 Për të qenë ymeti jotë mjaftë është për ne
 Kush të do ty edhe Zoti e do ate
 Gëzim i madh sot është për secilin njeri
 Që është musliman dhe është besnik i Tij
 Kush të dojë në Ahiret me gjet shefaat
 Pejgamberit gjithmonë ti çoi salavat.

3 herë Salavat

Allahum-me sal-li ala sej-jidina
Muham-medin neb-bijin umijin
Ve ala alihi ve sahabihi ves- sel-lim

Ndërrimi i jetës së Pejgamberit a.s.

Ta ndigjojnë gjithë besimtarët si ka kalu
Prej kësaj bote Ai Resul jetë si ka ndërru
Me të vërtetë në këtë dynja lajmi u dha
Në Ahiret do të shkojë Ai Resulallah
Erdhi koha për ta lën këtë dynja
Për të shku në Xhen-net ai Mustafa
Kur u ba gjashtëdhjetë e tre vjeç ai Emin
Xhebraili me urdhër të Zotit ia arrin
Me një fytyrë të qeshur e të bukur por si Han
Erdhi te Pejgamberi alejhis-selam
O Muhamed i tha, ty Zoti të çon selam
Në dëshirën tënde jam Zoti urdhëron
Kur e pa Xhebrailin ai Mustafa
Zemra ju dëshpëru shumë Atij kur e pa
Lotët prej syve të Atij binin në tokë
Ato që ishin aty të gjithë qanë me lot
I mërzit hyri në dhomë ai Resulallah
Ebija Fatimeja të mërzit e pa
Hazreti Fatimeja Resulit i tha
Përse je mërzit çfar ke ti o baba

Nuk kam gjë o Fatime merak mos u ban
 Me u taku me Zotin tem Unë dëshirë kam
 Dit për ditë rregull gjithmon siç e kishte ba
 Erdhë Bilali për ta thirr atë Mustafa
 Ja Resulallah i tha ti çfar urdhëron
 Koha për të fal namazin është ba tamam
 I tha Resuli o Bilal o vëllai im
 Për të fal namazin sot unë nuk kam fuqi
 Shko ti tek Ebu Bekiri thuaj atij
 Ta fali namazin ai shokëve tu prij
 Kur e ndigjoi Bilali këtë fjalë qau me za
 Dhe tek shokët erdhi e këtë lajmë e dha
 Shokët gjithsa ishin aqë shumë janë dëshpru
 Sytë ju rridhshin lot porsì ujë pa pushu
 Shkun të gjithë tek Pejgamberi për ta pa
 Halli jonë i thanë për mbas teje si ka me u ba
 Shkun e gjetën Pejgamberin shumë sëmur
 Për çështje të fesë Ai i porositi shokët shumë
 Porosit e mija ju tha mos me i harru
 Unë kam dëshirë tek shokët e mi për të shku
 Amanetin që Zoti mua ma ka dhan
 Fenë e Tij unë amanet jua kam lan
 Mos tu rrej dynjaja se e përkohëshme është
 Merrni atë që ajo e përhershme është
 Se çdo gjë me shpirt vdekjen ka për ta provu
 Amanet tek Zoti po ju lej unë ju
 Gjithkush ta dij se feja e Zotit është plotësu
 Luti Zotit nga gjynahet me u largu

Mos shkoni pas qefit dhe lakmis pa kufi
Halli juaj si ka me u ba veç Zoti e di
Mblidhe mendjen e ndigjo more i mjer
A nuk e ndigjon se çfarë thotë ai Pejgamber
Pejgamberin mbi të gjithë Zoti e lavdroi
Por prej vdekjes Ai atë nuk e shpëtoi
Aqë shumë Zoti e ka dashur atë njeri
Unë ti bëj malet flori i tha Atij
Pejgamberi në dynja asgja nuk kërkoi
Rahatinë e kësaj dynjaje nuk e pranoi
Ka ngrën bukë elbi Ai gjallë sa me jetu
Ka veshur këmishë prej lini sa me u mbulu
Zikër Zotin Ai e ka ba pa ja da
Dhe namazin asnjëher Ai nuk e la
Me i tregu vlerat e tij nuk kanë të mbaru
Zoti në Kuran Atë e ka lavdëru
Kush të doi që në dy botat të shpëtoi
Të ndjeki rrugën e Tij dhe salavat ti çoi

Salavati

All-llahum-me sal-li ala Muhamed
Neb-bijun Resulun ismuhu Ahmed
All-llahum-me sal-li alel Mustafa
Neb-bij-jun Resulun ve bahru safa
All-llahum-me sal-li alel Hashimij
Neb-bi-jun Resulun Ebul Kasimij

Me pikëllim vdekjen e Resultit ta ndigjojmë
 Duke qa me lot nga malli mos të pushojmë
 Kush do për atë Pejgamber që qan me lot
 Zjarrin e Xhehenemit e fik ai rob
 Ai njeri që nga dashuria sot qan për Te
 Nesër në Xhenet nurin e Zotin e sheh
 Zoti urdhëroj Xhebrailin dhe i tha
 Shko me Azrailin te ai Mustafa
 Azraili erdhë te porta thirri e tha
 Nga jashtë portës o familja Mustafa
 A ka leje në shtëpi unë dua të hyj
 Resulullahin du që ta shikoj me sy
 Fatimeja i foli edhe atij i tha
 Baba është i sëmurë përgjigje i dha
 O Arab më thuaj përse e do babën ti
 Jemi në hall natë e ditë me lot në sy
 Unë nuk iki Azraili asaj i tha
 Po se pashë me sy unë atë Mustafa
 Fatimeja i tha ti kushë je që flet kështu
 Dhe nga porta nuk po do me u largu
 Jam një katundar o Fatime i tha
 Me ardhë këtu Zoti kështu caktu e ka
 Unë nuk iki kam një punë mbrenda të hyj
 Kam shumë mallë Resulin dua ta shoh me sy
 Tha Fatimeja o baba ç'është ai njeri
 Që nuk ikën se do që të hyj në shtëpi
 Tha Resuli më ndigjo moj Fatime
 A me të vërtetë ti katundar e mendove ate

Është ai që shumë shtëpija i shkretton
 Edhe sytë e njerëzve me rrjedh lot i ban
 Miq e shokë motër e vëlla ai i ndan
 Babë e nanë i merr fëmijët jetima i ban
 Për të marrë shpirta ai shetit gjithë dynjan
 Kur vjen vdekja gjithkush shpirtin ia dorëzon
 Emrin Azrail ia thonë të vij thuaj atij
 Nuk kanë shpëtim prej tij as njerëz e as xhinij
 Fatimeja atëherë portën ja çel
 Brenda në shtëpi hyn pastaj ai Azrail
 Kur e pa Azrailin ai Mustafa
 Mirë se erdhe o melek atij i tha
 A për vizitë ti ke ardhë sot për të më shiku
 Apo me më marr shpirtin Zoti të ka urdhëru
 Për vizitë kam ardhë këtu unë o Fatmadh
 Në qoftëse do ti edhe shpirtin me ta marr
 Zoti mua më ka dhan urdhër që të vepro
 Bindju Pejgamberit ai si të dëshiroj
 Urdhërin e Zotit çoje në vendë i tha atij
 O Azrail për ty unë kam një porosi
 Kur ti vish ymetit tim ti vish me ngadalë
 Shpirtin atyre me lehtësi me jua marrë
 Mundimin e atyre ti mua ma jep
 Mos i mundo ti ato se i kam ymet
 Mundimin e atyre unë e heq ti më ndigjo
 O Azrail prej teje nuk du tjetër gja
 Prej Allahut atë çast thirri një za
 O Muhamed urdhëroj Zoti i tha

Mos ke hallin e ymetit o Resul
 Çfar deshe ti lutja jote u pranu
 Kë të duash ti për ymet ai ka shpëtim
 O Zot të lutem tha ban mëshir për ymetin tim
 Kur u nda prej të gjithë shokëvet ai Nebij
 Një nga një të gjithëve ju tha lamtumir
 Lamtumirë o nuri i syvet Fatime
 Lamtumirë ymeti im dhe ti Aishe
 Fatimeja e bija e Tij duke qa me lot
 Unë po bahem tha o baba kurhani jot
 Gjithë kalimtarë jemi moj bij në këtë dynja
 Lamtumir o ehlibejti im Ai tha
 O ju shokë unë amanet ju a kam lanë
 Ymetit tim ju bani prej meje selam
 Mos dëshprohi që po ndahem unë me ju
 Shpejt në Xhenet keni me u taku me mu
 Imam Hasanin dhe Hysenin në gjunjë i vu
 Në Xhenetin Firdeus u takofshim tha unë me ju
 Me keqardhje Pejgamberi jetë ndërroj
 Shpirtin ai Resul Allahut ia dorëzoi
 Në këtë dynja nuk jetoj ai Resulullah
 Për të jetu gjithmonë këtu shpresë kush nuk ka
 Sado shumë që një njeri të jetoj në dynja
 Ma në fund ai ka me vdek shpëtim nuk ka
 Sikur të ishte gjë që vlente kjo dynja
 Kishte jetu gjithmonë këtu ai Mustafa
 O Zot në rrugën e Result na drejto
 Ban mëshirë për ne dhe prej Tij mos na largo

Zoti nai faltë gjynahet që kemi ba
Dhe shefaat inshaallah ban Ai Mustafa
Kush të dojë që në dy jetët të shpëtoi
Të ndjekë rrugën e Tij dhe salavat ti çoi

Salavat

Allahum-me sal-li ala sej-jidina
Muhamedinin neb-bij-jun umijin
Ve ala alihi ve sahibhi ves-sel-lim.

LUTJA E MEVLUDIT

**El-hamdu lil-lahi Rrab-bil aalemijn
Ves-salatu ves-selamu ala Resulina Muhamed**

Falenderimi dhe lutja janë për Zotin e madhrushëm
Përshëndetja dhe nderimi janë për Profetin e lavdrushëm
Selami i Zotit qoftë për profetin Muhamed
Për familjen e tij, shokët dhe gjithë pejgamberët
Këtë lutje kushdo që ta ndigjojë
Me shpirtë dhe me gojë aminë le të thotë
O Zot i Madhrushëm për ne bëj mëshirë
Prej Teje e presim gjithmonë çdo të mirë

Ja Rabi o Zot nai fal gjynahet që kemi ba
 Veç Teje që na shpëton tjetër nuk ka
 Të lutemi o Zot të metat tona na i mbulo
 Dhe në fenë Islame deri në vdekje na qëndro
 Të lutemi o Zot prej teje kërkojmë shpëtim
 Kur të na e marrësh shpirtin na e merr me besim
 Të lutemi o Zot na e sjellë neve kollaj vdekën
 Vetëm tek Madhëria jote ne e mbajmë shpresën
 Të lutemi o Zot madhria jote neve na shpëto
 Prej mëshirës së Madhëris Tande mos na largo
 O Zot i Madhrushëm Ti na ndihmo neve të mjerë
 Të lutemi të na mbrojsh nga të ligat çdo herë
 Ja Rabi o Zot neve nuk ka kushë që të na shpëtojë
 Vetëm ti o Zot që madhëria jote na krijoi
 Të lutemi o Zot halli jonë nuk dimë si ka me u ba
 Në qoftë se Ti për ne mëshirë nuk ke për të ba
 Të lutemi o Allah neve na drejto
 Në xhehenem neve mos na dëno
 Ja Rabi veç te Ti e mbajmë shpresën o Allah
 Veç Teje që na shpëton tjetër nuk ka
 O Allah në dënosh Ti nga njerëzit e tu
 Neve na fal se mëshira jote nuk ka të mbaru
 Gjynahet e njerëzve Tuaj nuk janë asnjë gja
 Para mëshirës Tënde që mbarim nuk ka
 O Allah nai fal gjynahet që kemi ba
 Për hatër të atij Muhamed Mustafa
 Të lutemi o Allah na ban prej ymetit të Tij
 Dhe na mblidh të gjithëve nën flamurin e Tij

Pejgamberët tjerë thonë o Zot na mëshiro
 Muhamedi i lutet Zotit ymetin tim ma shpëto
 Ke të dojë e të pranojë ai Resulë për ymet
 Dyshim nuk ka, ai njeri shpëtim ka për të gjet
 Dhe për hatër të njerëzve të mirë euvlija
 Që i luten Zotit natë e ditë duke qa
 Na i prano lutjet tona o Zot që lutjet i dëgjon
 Bukurinë e xhenetit na e ban ta shikojm
 Na ban që atje ujë keuvtheri për të pi
 Dhe në xhenet për të gëzu çdo mirësi
 Ban mëshirë o Allah për njerzit e Tu
 Të kënaqemi bukurin Tande duke e shiku
 Kur ta shohim Zotin në xhenet nuk dim me e tregu
 Mbas kësaj mirsie të tjerat kemi me i harru
 Me u tregu qefi në xhenet o besimtar
 Mendja nuk na e merr por Zoti na e sjelltë mbar
 Qoftë salatë për Pejgamberin dhe selam
 Dhe për shokët e Tij të gjithë sa jan
 Sidomos mbi ata të katër shokë qoftë selam
 Se kanë ndejt me Pejgamberin ata gjithmon
 Hazreti Ebu Bekir dhe Hazreti Ymer
 Ndër shokët e Tij ata kanë qenë me shumë vlerë
 Hazreti Osman e Hazreti Ali
 Që ranë shehidë-dëshmor në rrugën e Tij
 Këta të katër nga njëri tjetri kush i dallon
 Nuk është me mua tha Pejgamberi
 Dhe Allahu atë njeri nuk e do
 Qoftë selam për Ehlibejtin=familjen e Tij

Dhe për muslimanët që ndoqën rrugën e atij
I kënaqur qoftë prej të gjithëve ai Emin
Rahmeti i Zotit për besimtarët pa përjashtim
O Allah që ke krijuar gjithë dynjan
Kuranin dhe Mevludin që kënduam na e prano
Dhe atij njeriu që u bë shkaktar që u këndu ky Mevlud
Zoti i dhashtë të mira dhe nga të ligat e rujtë
Për atë njeri që Mevludin e përpunojë
I lutem Zotit që atë edhe neve të na mëshirojë
Selami i Zotit qoftë mbi enbija e murselin
Vel hamdu lil-lahi Rrab-bil aalemin

Lil-lahi el-Fatiha.

Hallet e Vdekjes

Zoti madhrushëm kështu e ka caktu
Çdo gjë me shpirt vdekjen ka për ta provu
Vjen një kohë që gjithë fuqija të mbaron
Mallin dhe dynjan këtu ke për ti lan
Vdekjes ilaç nuk i kanë gjet në dynja
Kur të vië caktimi askush shpëtim nuk ka
Në se e vrasin ose mbytet një njeri
Vdekja është e shkrome s'ka shpëtim kur të vinj

Kur ti vië koha me vdek robi i mjer
 Azraili vjen shpirtin atij me ia nxjerr
 Vijnë melektë e rriskut duke i tregu
 Dhe i thonë se ushqimi e fryma të janë mbaru
 Gjithë dynjanë ne sot për ty kemi kërku
 Një ilaç nuk kemi mundur me diktu
 Në qoftë i mirë melektë e mëshirës i vinë
 E përkëdhelin edhe te koka i rrinë
 Lajme të gëzushme i japin dhe të mira i thon
 Prej lezetit kur i delë shpirti nuk e kupton
 Në qoftë i keq melektë e dënimit i vijn
 Shpirtin ia marrin atij me shumë mundim
 Zoti na ruajt duke qenë robi në atë hall
 Vjen shejtani imanin do me ia marr
 Vjen e i rrin tek kambët ai i mallku
 Me një gotë plot me ujë para syvet ia lun
 Prej nxehtësisë robit i digjen mushkërit
 Kush e ka atë gotë me ujë ai nuk e din
 Kërkon me pi ujë prej shejtanit të mallku
 Të japë me pi i thotë por thuaj dhe ti si themi un
 I thotë shejtani mohoje Zotin thuaj nuk ka
 Fe dhe peygamber dhe ringjallje nuk ka
 Në qoftë njeri i keq edhe ky ashtu thotë
 Vdes i pa fe dhe në xhehenem ai shkon
 Pendimi nuk pranohet pastaj për atë njeri
 Kur ti vië shpirti në grykë me i dalë atij
 Pa besim ai njeri që ikën nga kjo dynja
 Vështir e ka ai kurrë shpëtim nuk ka me pa

Lum për atë njeri të mirë që është me imanë
 Mendja nuk i lun kurrë shejtanin e shanë
 Zoti im i thotë është Ai që më krijoi
 Feja ime është Islami që Zoti e çoi
 Kan me u ngjall njerzit kanë me dhan llogari
 Kijameti ka me u ba i thotë atij
 Nuk ka çfar i ban shejtani njeriut që di
 Këthehet edhe ikën ai duke bërtit
 Në qoftë se kalon njeriu me besim nga kjo jetë
 Engjëjt ia ngrejne shpirtin atij lart në qiellë
 Ia shetisin në qiellna dhe në xhenet
 Dhe ia sjellin pastaj aty ku ka vdek
 Ai që vdes dhe shkon me besim në ahiret
 Në çdo vendë shpëtim ai njeri ka për të gjet
 Ai njeri që nga dynjaja del pa iman
 Zoti na ruajt prej qiellnash e largojn
 Vdekja është e vështirë dhe nuk ngjan me asnjë gja
 Aty shihet halli jonë si ka me u ba
 Zoti vepron drejtë se Ai hatër nuk ka
 Po të mendohesh këtë gja e sheh dhe në dynja
 Mbret po të jetë ose pasanik ose fukara
 Do ta zhveshin lakuriq ate për ta la
 Sado që të ketë fëmij shumë edhe pasuri
 Gjithë një lloj do të hynë në varr vesh me qefin
 Kur të vdesi duke qenë i shtrir në dyshek
 Hidhrohen fisi miqtë e shtëpisë dhe shokët e vet
 Një melek i vdekjes atë e thërret
 Hape gojën çfar ke tani që nuk po flet

Ku e ke ti atë fuqi o i mjeri njeri
 Çfar të ka trupi që sot ti po rrin i shtri
 Ae munde ti dynjan apo dynjaja ty
 Ae mblodhe mallin ti apo malli ty
 Ae le dynjanë apo dynjaja të la ty
 A ti dynjan apo dynjaja të rrejti ty
 Kur të fillojnë për ta la njeriun që ka vdek
 Përsëri një melek aty një za thërret
 Kjo është vdekja që ti atë e pate harru
 Vetëm pare mall e famë ke dasht me fitu
 Mallin që e ka dasht si shpirtin ti ku e le
 Shih me sy sot njerëzit tjerë po lujnë me te
 Kur ta marrin e ta nxjerin prej shtëpisë
 Përsëri një melek aty ka për të thirrë
 Kjo është vdekja që shtëpin ty ta shkretton
 Edhe që të ndau ajo me babë e nanë
 Vdekja të vjen nga të shkosh ajo të gjen
 Fëmijët ti ban jetima e gruan ta len të vej
 Kur njeriu të hyjë në varr një za i thërret
 Ku i ke fëmijët e mallin o rob i shkret
 Fol e qeshu ku i ke ti sot miq e shokë
 Pse po rrin kaqë i mërzi mbrenda në tokë
 Vdekja është për të gjithë dhe miqtë do ti mundoi
 Toka mbushet me varre askush nuk do të shpëtoi
 Nuk ka çfarë i ban kushë atë deri në varr e çojnë
 Të gjithë këthehen dhe në varr vetëm e lanë
 Kush të doi që të mirat mos ti humbin atij
 Mos ti thotë njeriut Zoti ose Zotni

Mos ti thotë Zonjë i Zoti, imZot e ka Zotsi
Se një Zot është dhe nuk ka tjetër veç Atij
Kush i përdor këta fjalë duhet ta dij
Ka ba shirk gjynah të madh shumë ai njeri
Ai njeri që i ban Zotit shokë me gojë
Zoti atë rob në xhehenem do ta çojë
Kush të dojë që në dy botat të shpëtojë
Të ndjekë Pejgamberin dhe salavat ti çojë

Salavat

Allahum-me sal-li ala sej-jidina
Muhamedinin nebi-jun umijin
Ve ala alihi ve sahabihi ves-sel-lim

Fund

**MEVLUDI SHERIFË { I PËRMBLEDHUR}.
PREJ: HAFËZ ABDULLAH ZEMLAKUT-KORÇË**

BISMILAHİ RRAHMANI RRAHİM

All-llah emri i Zotit më par të kujtohet
Pastaj Pejgamberi duhet të nderohet

Emrin e All-llahut kushë kujton më parë
 Ç' do punë nga Zoti atij i vjen mbarë
 Kush kujton All-llahun gjithmonë në jetë
 Gjynahet i bien në tokë por si fletë
 Ai emri i pastër por sa të kujtohet
 Pastrohen gjynahet dëshira të mbarohet
 Me gjithë shpirt gjithmonë All-llah të thërrasim
 Që rahmet të gjejmë e musliman të vdesim
 Nga mëshira e Zotit mos ta presim shpresën
 Nëse do të pendohemi do ta kemi pjesën
 I vërtetë është Zoti nuk ka dyshim kurrë
 Sado që lajthisin disa zemërgurë
 Kur s'kishte gjë fare veç Zoti ka qënë
 Këtë botë në rregull Ai e ka vënë
 Para Zotit s'kishte as njerëz as diellë
 Për fuqinë e Zotit të mendojmë thellë
 Ai i krijoi tokën dhe qiellin
 Fenerë ndriçues Ai e ka bër diellin
 I krijoi Zoti me fuqinë e tija
 Se kishte për të ardhur në Tokë njerëzia
 E ç'ta zgjasim fjalën s'ka shok Plotfuqia
 Nuk ka dyshim fare për qënien e Tija
 Mëshirën e Zotit nëse e shpresoni
 Kur të përmendëni Zotin xhele shanuhu thoni
 Kush të dojë në ahiret me gjet shefeatë
 Gjithmonë Pejgamberit le ti çojë selamë

Salavatë

Es-salatu ves selamu alejke ja Resulallah
Es-salatu ves-selamu alejke ja Habiballah
Es-salatu ves-selamu alejke ja Nebijallah

Lutja e Mevlud-Shkruesit

Vëllezër të dashur po i them këto fjalë
Ai nuri i Zotit në shesh që të dalë
 E përkthym Mevludin ne në gjuhën tonë
 Vëllezërit besimtarë rahmet të na thonë
Nuri le t'i ndirisi kushë të na kujtojë
Mëshira e Zotit të gjithë ti mbulojë
 Kush na kujton neve dhe besimtarët sa janë
 Për hatrin e Zotit këndon Fatihanë

Lil-lahi el-fatiha

Lavdërimet i qofshin Zotit të vërtetë
Për ato të mira që na i dha në jetë
 Na ka dhënë fenë xhevahir imanin
 Na ka dhënë udhëzimin të lartin Kuranin
Krenar jemi neve ymeti i Muhamedit
Nderimet i qofshin gjithmonë Pejgamberit
 Amineja është nëna e Muhamedit
 Abdullahi është baba i Pejgamberit

Prej këtyre lindi i dashuri i Allahut
 I zbriti Kurani Resulit të Allahut
 Feja e Allahut është feja Islame
 Ndjekësit e kësaj feje quhen muslimanë
 Kjo fe e bekuar u përhap në Mekë
 Për fenë u përpoqën të gjithë sehabetë
 Pastaj kanë vajtur dhe nga Medineja
 E kthyen fytyrën të gjithë nga Qabeja
 Sehabetë janë shokët e Muhamedit
 Ata i besuan të gjithë Pejgamberit
 Duhet ta kujtojmë të gjithë ehlibejtin
 Edhe sehabetë që të gjejmë rahmetin
 Më parë tu them juve sehabet e ndërë
 Eshtë Ebu Bekri bashkë me Ymerë
 I treti i thonë: i miri Osmani
 Aliu është i katërti i thonë Luani
 Këta nga njëri tjetri cili i dallonë
 Nuk është me Pejgamberin dhe Zotin e hidhëronë
 I miri Hasani bashkë me Hysejnë
 Të Aliut janë nënë kanë Fatimenë
 Nënë Fatimeja e bija e Pejgamberit
 Nuk e kishte shoqen në faqe të dheut
 Hazreti Abazi bashkë me Hamzanë
 Xhajat e Resulit këta të dy janë
 Ehlibejtë e quajtën dhe hazreti Selmanë
 Pastaj më të mirët të luftës së Bedrit janë
 Mezini i parë Bilali i bekuar
 I kënaqur qoftë prej tyre Zoti i madhruar

Zoti qofë i kënaqur nga populli në Medine
E pritën Pejgamberin me shumë nderime
 Prej këtyre i kënaqur është Zoti i vërtetë
 Strehuan Pejgamberin me gjithë shokët e vet
Prej të gjithë shokëve u kënaq Pejgamberi
Me këta e përhap fenë i famshmi Muhamedi
 Kush të dojë nga ju prej xhehenemit të shpëtojë
 Të ndjekë Pejgamberin dhe salavat ti çojë

Salavat 3 herë

All-llahum-me sal-li ala sejidina Muhamedin
Nebij-jin umijin ve ala alihi ve sahibihî ves-selim

Kur u përhap feja u zgjerua vatani
U përhap anë e mbanë në botë muslimani
Edhe ne në qoftë se do ta mbajmë fenë
Me fenë do ta mbajmë të fortë dhe atdhenë
 Feja mbahet duke fal rregullishtë namazin
 Pastaj të agjërojmë edhe Ramazanin
Kush të jetë i pasur të japi zekatin
Dhe të shkojë në Qabe për të kryer Haxhin
 Ne Kuran të Zotit thonë shumë ajetë
 Për të menduar shumë njeriu në këtë jetë
Zoti i madhruar e krijoi njerinë
I ka dhënë mendjen të mësojë dituritë
 Për veprat e Zotit ta shtrydhim mendimin
 Si është krijuar bota të marrim kuptimin

Të shikojmë Qiellin pa shtylla ndërtuar
Mbushur anë e mbanë me yje të ndriçuar
 Të shikojmë Tokën ç' do gjë kafshë e bimë
 Të mirat e Zotit të gjitha për njerinë
Shpendët dhe ç'ka janë gjithë bagëtia
Të nënshtruara janë të gjitha tek njerëzia
 Dielli është i zjarrtë edhe shumë i ndritur
 Hëna rrotull tokës vjen duke u vërtitur
Për fuqinë e Zotit të mendojmë thellë
Se qysh ikën nata e shfaqet prapë Diellë
 Gjithë shpendët që janë Zotin e lavdërojnë
 Edhe bagëtia Zotin e njisojnë
Shenjat e All-llahut për neve mjaftojnë
E forcojnë besimin ata që mendojnë
 Me dritën e mendjes dallojnë njerëzia
 Nga kafshët që janë në tokë me mijra
Duhet ta njisojë njeriu Zotin fuqiplotë
Prandaj i krijoi Ai njerëzit në këtë botë
 Mos e thirrni njeriun Zoti dhe Zotnia
 Mos thoni Zonjë e i Zoti e Zotit është Zotësia
Kush i përdor këto fjalë ai duhet ta dijë
Zoti këtë gjynah të madhë nuk ia fal atijë
 Zoti është Allahu që na ka krijuar
 Nga fjalët e kufrit duhet me u larguar
Kush i bën All-llahut ortakë me gojë
Atë njeri në xhehenem Ai do ta çojë
 Njeriu kur të vdesi në tokë ka sualë 'pytje'
 Në natën e varrit ka gjykim me fjalë

I thonë melekët ç'farë pate besuar
 Krijuesi ytë kushë ishte, kë ke vertetuar
 Në dhëntë përgjigje në tokë i mbuluar
 Varri do ti shfaqet si kopësht i lulëzuar
 Njerëzit që kanë mendje kanë dhe përgjegjësinë
 Ata në botën tjetër do të japin llogarinë
 Dita e llogarisë atëherë kur do të jetë
 Secili nga njerëzit sheh hallin e vetë
 Për jetën e këtushme njeriu ka punuar
 Por jetën e atjeshme nuk e ka menduar
 Do t'i thotë Zoti ashtu si din vetë
 Shumë të mira të dhashë o njeri në jetë
 Të mirat e mia ti nuk i vlerësove
 Pse nuk mu përule nuk më falenderove
 Vëllezër besimtarë të mendojmë për atë jetë
 Mos ta kemi mendjen veç tek paraja e shkretë
 Se kjo botë është ara e Ahiretit
 Besimtari të mbjelli lulen e xhenetit
 All-llahu i madhëruar xhenetin e krijoi
 Besimtarët e Tij atje Ai do t'i çoi
 Armiqtë e fesë do të shkojnë në xhehenemë
 Nga që nuk besuan atje do të jenë
 Ata që besuan por namaz nuk bënë
 Po s'i fali Zoti në xhehenem do të jenë
 Me besim në qofshin gjithmon nuk do të rrinë
 Për nder të Pejgamberit pastaj në xhenet vijnë
 Mevludin e Resulit duhet ta këndojmë
 Dhe si Pejgamberi ne duhet të veprojmë

Ai është shembull për neve në jetë
Kështu thotë Kurani që është i vërtetë
 Kush të dojë nga njerëzit rrugën e shpëtimit
 Ai le të ndjekë mësuesin e njerzimit
I dërguari i Zotit më i bukuri ka qenë
Si ai të ngjajshëm nuk vinë më në jetë
 E mbaruan fuqinë gjithë dijetarët
 Me lavdërimet për atë si mbarojnë fjalët
Nga vlerat e tija marrim shumë mësim
Nuk mbarohen librat të gjitha me lavdërim
 Kush të dojë nga ju prej zjarrit të shpëtojë
 Të ndjekë Pejgamberin dhe salavat t'i çojë

Salavatë

All-llahum-me-sal-li ala Muham-med
Neb-bij-jun Resulun ismuhu Ahmed
All –llahum-me-sal-li alel Mustafa
Neb-bij-jun Resulun ve bahru safa
All-llahum-me sal-li alel Hashimijn
Neb-bij-jun Resulun ebul Kasimij

Fund

**Mevludi sherifë { i përmbledhur}.
Prej: Hafëz Abdullah Zëmlakut - Korçë**

**E përpunoi: Haxhi Ymer Aga.
Imami i xhamis Farkë-Tiranë.**

2013

ARGUMENTAT E DIJETARËVE TË PARË ISLAM PËR FESTIMIN E MEVLUDIT-DITËLINDJES SË PROFETIT MUHAMED A.S.

Dijetari mirënjohur Ebu Bekër Sujuti në veprën e tij El Havi lil Fetava në lidhje me mevludin thotë; Veprimet për mevludin sic është; mbledhja e njerëzve, leximi i pjesëve të Kuranit i salevateve=përshëndetjeve, tregimi i ngjarjeve dhe i ndodhive para, gjatë dhe pas lindjes së Pejgamberit a.s, të mbështetura në fakte, dhe shtruarja e ndonjë gostije për besimtarët, janë padyshim vepra të mira. Ai që i bën shpërblehet me sevabe-mirësina nga Allahu xh.sh, sepse i bëhet respekt autoritetit të Pejgamberit a.s, dhe shprehet gëzim e hare për lindjen e tij. Ky është mendimi e fetvaja e Sujutiut. Dijetari i mirënjohur bashkëkohorë Muhamed Myteveli Sharavi, në librin e tij Maidetul Fikril Islamije faqe 295, thotë; Kur gjithë njerëzit në atë kohë janë gëzuar me ardhjen e Pejgamberit Muhamed a.s, në këtë botë, janë gëzuar dhe gjithë krijesat tjera, engjëjt, xhinët, kafshët, shpendët, bimët, bota Inorganike e përse vallë mos të gëzohemi ne sot dhe ta festojmë ditëlindjen e tij? Në sahihul Buhari përmendet se Pejgamberi a.s. ka thënë se; "Cdo ditë të hëne Ebu Lehebit i ndërpritet dënimi në zjarrin e xhehenemit sepse ai u gëzua kur mori lajmin për lindjen time nga shërbëtorja e quajtur Thuvejbe dhe ai e shpërbleu atë për lajmin e gëzushëm që i dha ajo." Dijetari Ibni Xheriri thotë: Meqenë se një qafir i betuar kundër Pejgamberit a.s, si Ebu Lehebi përfiton mbrenda në xhehenem vetëmse u gëzua kur lindi Pejgamberi a.s. mendoni tani se çfarë favorit se çfarë të mirash do të ketë një besimtarë që gëzohet për ditëlindjen e hazreti Muhamedit a.s. Imam Tirmidhiu tregon këtë hadithë se Pejgamberi ka thënë; Kush gëzohet për mua [për lindjen time] edhe Allahu xh.sh. është i kënaqur prej atij njeriu." Dijetari Imami

Shafiu ka thënë; Cdo veprim që nuk e kundërshton Kuranin e synetin është i mirë është i lejuar.Në Mevlud nuk ka kundërthënie nëse fjalët që thuhet janë të bazuara në Kuran e hadith.

Disa dijetarë Islam mendojnë se festimi dhe gëzimi për ditë lindjen e Pejgamberit a.s.është i qartësuar dhe nga ky ajet i Kuranit: "Thuaj vetëm mirësisë së Allahut dhe mëshirës së Tij le t'i gëzohen [besimtarët]..."S.Junus.aj.58.Sipas komentatorëve të Kuranit mirësia më e madhe për besimtarët është dërgimi i Pejgamberit a.s.si mëshirë për gjithë botrat, mëshirë për çdo gjë.Allahu xh.sh.në Kuranë ka thënë; "Betohem për jetën tënde o Muhamed.] S.Hixhër aj.72.Dijetari i njohur Islam Ibni Tejmije në në librin e tij Iktidau-us Siratul Mustekijm Muhalefetu As-habil Xhehim thotë; "Të respektuarit e Pejgamberit a.s.që disa nga njerëzit e bëjnë,është vepër e mirë që do të shpërblehet prej Allahut xh.sh.për shkak të gëzimit e respektimit që i bëjnë besimtarët atij.Ibni Tejmija thotë se jo vetëm që lejohet të festohet festa e Mevludit -lindjes së Pejdamberit a.s.porë ai thotë se ata që e festojnë këtë ditë për dashurin që kanë ndaj Pejgamberit a.s.do të shpërblehen nga Allahu xh.sh.Nëse e lexoni librin e Ibni Tejmijes do të shikoni në të se ai ka shprehur mendimin e tij se festimi i ditë lindjes së Pejgamberit a.s.është vepër e lejuar e pëlqyer dhe nuk është vepër e ndaluar sikurse thonë disa xhahila=injoranta dhe disa mendje shkurtër të vetëqujtur "selefi"me nxitjen që ju bëjnë atyre qafirat e munafikët kudo në bote për të ulur poshtë autoritetin e Muhamedid a.s.dhe për të zbehur dashurinë që kanë besimtarët muslimanë ndaj tij.Autoritetin e Pejgamberit a.s.e ka ngritur lartë vetë Allahu xh.sh.në Kuran i cili thotë: "Lart ta ngritëm famën tënde o Muhamed. "S.Inshirah.aj.4. Edhe ne o vëllezër muslimanë duhet ta ngremë lart famën e Muhamedid a.s.Njëra nga mynyrat e ngritjes së famës së tij është dhe përkujtimi me ceremoni i ditëlindjes së tij nga muslimanët bashkërisht.Allahu xh.sh. në Kuran i ka thënë Pejgamberit a.s.: "Thuaju [besimtarëve] jam

urdhëruar të jemë i pari i muslimanëve.”Pa dyshim i pari duhet të nderohet.Kur e kan pyetur Ibni Tejmijen për ata njerëz që mblidhen në një vënd së bashku për të lexuar e dëgjuar Kuran,për të bërë zikër Allahun xh.sh.dhe përshëndetur e lavdëruar Pejgamberin a.s.me salavatë me qëllimin për të përfituar kënaqësinë e mëshirën e Allahut xh.sh.,ai ka thënë: Elhamdulilah grumbullimi i njerëzve për të dëgjuar Kuran,për të bërë zikër dhe për të ju lutur Allahut xh.sh.nuk ka dyshim se janë vepra të mira e të urdhëruara në Kuran.Atë herë nuk ka dyshim se me kënduar Kuran dhe me nderuar,lavdëruar dhe me përshëndetur me salavat Pejgamberin a.s.është pa dyshim vepër e pëlqyeshme,vepër shumë e mir por me kusht që lavdrimi të jetë brënda masës ose kufirit që e lejon feja Islame.

Ndërsa Imam SeHAVIU ka thënë: Edhe sikur në bërjen e Mevludit nuk do të kishte asnjë të mir por vetëm prej asaj që shejtanët e mallkuar,qafirat dhe mynafikët hidhërohen për nderimin që i bëhet Muhamedid a.s.e ndërsa besimtarët gëzohen,vetëm kjo gjë do të mjaftonte për festimin e Mevludit fisnik-ditëlindjes së Pejgamberit tonë Muhamedit a.s.Dijetari Ebu Shame,mësuesi i Imami Neveviut ka thënë;Më e mira shpikje e bukur që është paraqitur sot në kohën tonë është grumbullimi që njerzit mblidhen çdo vitë për festimin e ditëlindjes së Pejgamberit tonë a.s.duke shprehur gëzim e hare për lindjen e tij dhe duke dhënë sadaka e hedije-lëmoshë e dhurata me rastin e kësaj dite të madhe.Të tilla shpikjesh të mira pas Pejgamberit a.s.kemi bërjen e minareve të xhamiave,mbledhjen dhe regjistrimin e haditheve të Pejgamberit a.s,vënjen e çallmës në kokë nga dijetarët e fesë e tjera.Pejgamberi a.s. ka thënë : ‘Atë gjë që muslimanët e vlersojnë për të mirë edhe tek Allahu xh.sh.ajo është e mirë.Ndihma e Allahut xh.sh.është me xhemat dhe kush ndahet nga xhemati ai ndahet për të shku në xhehenem.’ Ibni Haxheri thotë se Mevludi ka bazë në synet se Pejgamberi a.s.kur erdhi në Medine i gjeti Jahuditë-çifutët e asaj kohe që agjëronin ditën e ashures dhe kurë

i pyeti se përse agjëroni,ata i than;Është dita që Zoti xh.sh,fundosi në detë Faronin dhe shpëtoi Musain a.s.Ne u tha Pejgamberi a.s,atyre jemi më të merituar se ju që të agjërojmë. Ne e besojmë atë për pejgamber."Kjo transmetohet në Buhari dhe Muslim.Pejgamberi a.s.agjërojë në atë ditë, si falenderim Allahut xh.sh.që e shpëtoi hazreti Musain a.s. Atëherë këtu kemi të bëjmë me kijas-krahasim se qëllimi është i njëjtë. Kështu pra duhet që dhe ne ta falenderojmë Allahun xh.sh,që me anë të hazreti Muhamedit a.s,e shpëtoi njerëzimin nga injoranca dhe armiqësija.A ka mirësi më të mirë e më të madhe se lindja e këtij Pejgamberi që është mëshirë jo vetëm për muslimanët por për të gjithë njerëzit dhe për gjithë krijesat e gjalla se ai tregoi bazat themelore për mbrojtjen e të drejtave të njerëzve dhe të kafshëve.Gjithashtu Pejgamberi a.s.ka agjëruar në ditën që ka lindur vetë që të nesërmen pastaj ishte dita e mevludit-lindjes së tij. Pejgamberi a.s.e ka agjëruar në ditën kur ka lindur vetë si shenjë falenderimi Allahut xh.sh,që e solli në këtë jetë. Pejgamberi a.s.gjithashtu ka agjëruar gjithmonë në ditët e hënë dhe të enjte.Kur e kanë pyet se përse e agjëron? Ai për ditën e hënë ka thënë; "Të hënëën linda,të hënëën ka filluar të më vinjë shpallja,dhe të hënëën bëra hixhretin. "Trans Muslimi. Dijetari i dëgjuar Imam Bin Ijadi ka thënë; Festimin e ditëlindjes së Pejgamberit a.s.unë e quaj festë për gjithë muslimanët.Festë në të cilën muslimanët shprehin gëzimimin dhe harenë e tyre për lindjen e Pejgamberit a.s.të dërguarit të Allahut xh.sh.Dijetari i mirë njohur Sujutiu thotë se festimi i ditëlindjes së Pejgamberit a.s.është i lejuar dhe është veprim i mirë-me vlerë. Mendimin e tij ai e mbështet në një transmetim të Bejhekiut nga sehabi-shoku i Pejgamberit a.s,Enesi r.t.a. që ka thënë se; Pejgamberi a.s.ka therë kurban për ditëlindjen e tij,për të falenderuar Allahun xh.sh.Kështu që është pa dyshim e rekomandushme dhe për ne muslimanët që ti shprehim Allahut xh.sh,falenderimet tona për lindjen e Pejgamberit-lindjen e profetit Muhamed a.s.Dijetari i

mirënjohur ish myftiu i Mekës në Arabinë Saudite Ahmed Zejni Dahlani që ka vdekur në vitin 1066,ka thënë;Tradita e njerëzve të cilët festojnë ditëlindjen e Pejgamberit a.s.për respekt e nderim ndaj tij,është vepër e lejuar dhe është mirë që të praktikohet.Dijetari dhe muxtehidi i mirënjohur Shevkaniu rahmetullahi alejh ka thënë;Festimi i mevludit-ditëlindjes së Pejgamberit a.s,është vepër e mirë që lejohet të bëhet.Ndërsa historiani i njohur i shekullit të 8 Ibni Batuta tregon;Pas çdo namazi të xhumasë dhe në ditën e lindjes së Pejgamberit a.s,dyrët e Qabes hapeshin nga rojet e saj dhe kadiu i Mekës Nexhmedin Muhamed bin el imam Muhjidin Taberiu,shpërndante ushqim për njerëzit në qytetin e Mekës.Nga fjalët e tij kuptohet që në festën e mevludit ka shumë sevab-shumë mirësina ti japësh sadaka-lëmoshë të varfërve,të ndash dhurata dhe të shtrijë gosti për njerëzit ai që ka mundësi,si shenjë dashurije kjo për Pejgamberin a.s.Allahu xh.sh.thotë në Kuran:"Ata që bëjnë vepra të mira ju takon e mira edhe më shumë."S.Junus.aj.26.Ndërsa në suren Nisa aj.128.Allahu xh.sh. ka thënë: "Kush angazhohet për të mirë do të ketë të mirë." Vetëm djalli mallkuar, qafirat dhe munafikët-hipokritët janë të hidhëruar për lindjen e tij. Pejgamberi a.s, ka thënë: "Kush gëzohet me mua edhe Allahu xh.sh. është i gëzuar prej atij njeriu."Trans Imami Tirmidhi.Shabët-shokët e tij e kanë lavdruar Pejgamberin a.s,kur ai ishte gjallë.Shembull kemi Ebu Bekrin që një ditë i tha Pejgamberit a.s.;Kam shetituar në shumë vende o i dërguari i Allahut xh.sh,por njeri më të bukur si ti nuk kam pa.Po kështu poeti i njohur i asaj kohe Hasan Thabiti ka thënë;Më të hijshëm se ti nuk kanë parë sytë e mi ,më të bukur se ti nuk kanë lindur gratë ndonjë fëmij.Ti je i krijuar në trup pa asnjë të metë,ashtu deshi e të krijoj Zoti i vërtetë.Edhe pasi ndërroi jetë Pejgamberi a.s.shumë dijetarë të ndryshëm e kanë lavdruar atë duke i përmendur cilësitë dhe mrekullitë e tij.Të tillë janë Ebu Hanifeja me kasiden e tij të famëshme që është e njohur në të gjithë botën.Ebu Siriu me kasiden burde të tij e të tjerë.Dijetarët

Islam në çdo vëndë të botës,në ditën e lindjes së profetit Muhamed a.s.veçë këndimit të Mevludit që duhet ta këndojnë me shum respektë në gjuhën që njerëzit e kuptojnë,duhet të mbajnë dhe ligjërata të ndryshme për jetën e tij se Pejgamberi a.s.është shembulli i të gjitha mirësive.Allahu xh.sh.thotë në Kuran: "Nëse doni ju një shembull të përkryer për ndreqëjen e moraleve tuaja o besimtarë,betohem se këtë shembull e keni tek i dërguari im Muhamedi a.s."S.Ahzab.Ndërsa për veprat e mira veç detyrës =asaj që quhet farz Allahu xh.sh.thotë : "Ata që bëjnë vepra të mira ju takon e mira edhe më shumë."S.Junus.aj.26.

Mevludi festohet kudo në bote si në Egjipt, Turqi, Algjeri, Tunizij, Marok, Liban,

Jemen,Irak,Bosnje,Libi,Maqedoni,Kosovë,Siri,Indonezi,Shqipëri e tjera vende.Dijetari i mirënjohur Islam Imami Gazaliu në librin e tij Ihjai ulumid-dijn ka thënë se gjatë vitit janë 15 ditë me vlera të mëdhaja.Këto janë: 6 ditë ose netë Brenda muajit Ramazan dhe janë nata e 17,21,23,25,27 dhe 29 e këtij muaji për shkak të natës së madhe =natës Kadër.E dymbëdhjeta natë e hënës Rebiul-Evel [nata e lindjes së Pejgamberit a.s.=Dita e Mevludit,nata e parë e mujit Muharrem[vitii ri për muslimanët=me kalendarin musliman Hixhri e dhjeta ditë e muajit Muharrem=Ashurja.],Nata e parë e muajit Rexheb=Nata e madhe ose nata e mirë e para.Atë natë u formua në barkun e nënës së tij profeti Muhamed a.s.Nata e 27 e muajit Rexheb=[nata e mir e dyta [nata e Isras dhe Miraxhit], Nata e 15 e muajit Shaban [nata e madhe ose nata mirë e treta=nata e Beraetit],Nata e 9 e mujit Dhul-Hixhe [Dita e Arafatit dhe],Dy netët e dy Bajrameve.Pas natës së Kadrit në të cilën natë zbriti Kurani nata më me vlerë ps saj është nata e Mevludit për arsye se Kurani i zbriti Muhamedid a.s.i cil lindi në këtë natë. Kështu që këto dy netë janë të afërta në vlera njëra me tjetrën.Të nderosh natën që zbriti Kurani dhe mos ta nderosh natën që lindi Ai të cilit i zbriti Kurani, kjo gjë është e çuditshme është e pa pranushme.Muslimanët në përgjithësi por sidomos të diturit,duhet

të jenë krenarë që përkujtojnë me respekt të madh, ditëlindjen e Profetit Muhamed a.s. njeriut me famën më të madhe në gjithë historinë e njerzimit që nga krijimi e deri në shkatërrimin e botës. Ai është [mëshirë për botrat]. Profeti Muhamed a.s. është themelusi i paqes në mbarë botën. Feja Islame që i komunikoi botës profeti Muhamed a.s. është ilaçi i shërimit të krizës morale për mbarë njerëzimin. Të gjithë njerëzit e mençur duhet ta kuptojnë këtë gjë dhe që ta kuptojnë duhet të studiojnë me hollësi Kuranin dhe jetën e profetit Muhamed a.s. Intelektualët janë borxhëli ndaj profetit Muhamed a.s. se ai e ngriti lartë vlerën e të diturve mbi të pa diturit, kur ju komunikojë njerëzve fjalën e Allahut xh.sh.-ajetin e Kuranit; "Nuk janë të njëjtë ata që dijnë, me ata që nuk dijnë." Profeti Muhamed a.s. ka qënë personaliteti më i madh në jetën e përditshme shoqërore civile e ushtarake. Ai ka qënë dhe një krytarë shteti i shquar, një organizatorë e administratorë i përsosur, një komandantë i zgjuar dhe shumë trim, një ushtarë i disiplinuar e një gjykatës i drejtë e i pa shembullt në zbatimin e drejtësisë, duke u ba kështu njeriu me famën më të madhe në faqen e tokës, njeriu që e shkriu jetën e tij për ti bërë mirë njerëzimit. Bota as nuk ka parë dhe asë nuk ka për të pa njeri më të ditur, më bamirës, më human dhe me veti morale më të larta se profetin Muhamed a.s. Vërtetë ai është shembulli i të gjitha mirësive. Profetin Muhamed a.s. e ka ngritur në shkallë të lartë vetë Krijusi i Gjithësisë= Allahu xh.sh. që e dërgoi atë për mbarë njerëzimin dhe thotë për të në Kuran: "Të kemi dërguar ty [o Muhamed] mëshirë për të gjithë botrat." S.Enbija aj.107. "Me të vërtetë ti [o Muhamed] je në një shkallë të lartë të moralit." O ju vëllezër musliman; duhet ta dini se "Allahu xh.sh. gëzohet kur njerëzit mblidhen së bashku për festën e Mevludit të gëzuar për ta nderuar e lavdruar më të dashurin të dërguarin Tij Muhamedin a.s." Ju o vëllezër besimtarë të sinqertë mos ia veni veshin disa mendje lehtëve që kan ra në kurthet e intrigave të armiqëve të Muhamedit a.s. Kurani thotë: "Është e vërtetë se Allahu dhe

melekët [engjëjt] e Tij me krenari e lavdrojnë Pejgamberin.O ju besimtarë ngrejani lartë famën e tij-nderonjai atë [dhe ju] dhe përshëndeteni [atë] me selam."S. Ahzab.aj.56. Të gjitha lavdrimet e titujt më të lartë që i përkasin njeriut që e meriton, i përkasin Pejgamberit a.s.porë vetëm emri Zoti ose Zotëri, ibiri i Zotit, i Zoti,i del Zot,e Zotnon ose ai ka Zotësi, nuk lejohen kurrë nga feja Islame në baz të Kuranit ti thuash atij dhe çdo njeriu tjetër në çdo gjuhë qoftë ajo që fjalët kanë të njëjtin kuptim me të cilat emra të përveçëm në ato gjuhë thirret Zotin=Allahun xh.sh..Për shembull në maqedonisht nuk lejohet ti thuash njeriut Gospodin e Gospozha..në serbisht Bog,Bozhe e Bogorodica, në gjuhën italiane Dio e Don ose Dom,në persisht ose në gjuhën Iraniane Mullah që do të thotë im Zot ose Allahi im, në greqishtë Theos e Qirja.Gjithashtu nul lejohet edhe në gjuhën arabe titulli Meuvlana që do të thotë i lartëmadhërushmi që indirektë fjala është për Allahun xh.sh.Këto fjalë ose tituj nderimi për njerzit janë pa dyshim shirk e kufër i madhë. Janë në kundërshtim të hapur me fen Islame, me fjalën e saj të madhe "La lahe li-lallah"= "Nuk ka tjetër Zotë veç Allahut."e cila fjalë në Kuran quhet fjala e fortë të cilën gjithë profetët e Zotit xh.sh.ju a than popujve të tyre.Mjer për ata njerëz që e vërtetojnë me gojën e tyre e duke e quajtur njeriun Zot estagfirullah dhe Zotin e bëjnë njeri estagfirullah.Gjithashtu dhe mjer për ata njerëz që pranojnë të thirren Zoti ose Zotnia e Zonja në çdo gjuhë të botës.Këto fjalë kufri e shirku kanë hyrë tek besimtarët e Allahut xh.sh.nga qafirat shumë kohë më parë. Dijetarët e fesë nuk kanë qenë vigjilentë për ta ruajt të pa prekur në çdo gjuhë domethënjen e fjalës së fortë ose fjalës së madhe "La ilahe il lallah"që do të thotë nuk ka tjetër Zotë veç një Zoti ose nuk ka tjetër veç Allahut xh.sh.Besimtarët e Zotit xh.sh.duhet të largohen me njëherë nga këto fjalë që janë kufër e shirk.Nuk duhet të flasin besimtarë fjalë kufri e shirku si ateistat=mohusat e Zotit xh.sh.Duhet të distancohen me njëherë nga ateistët të cilët nuk e besojnë Zotin xh.sh.dhe jetën tjetër pas

vdekjes.Ky është parimi bazë i fesë për besimtarët e Allahut xh.sh.në faqen e tokës.Mos flisni edhe ju o besimtar fjalë kufri e shirku si ata. O besimtarë në vend të fjalës Zoti ose Zotëri, Zotnesh e Zotnush ose ndryshe në dialektin e Shqipëris së jugut Zonja e Zonjusha, përdorni fjalën “i nderuar e nderuar ose i nderum dhe e nderume- të nderuar e të nderuara”dhe sipas rastit që të jetë edhe fjalë tjera si përshembull; shkëqesi, efendi, uratë,vëlla,i dashur e tje.Edhe fjala shok është e lejuar nga ana fetare të përdoret.dhe mundë ta përdorin njerzit për njëri tjetrin.Pejgamberi ynë Muhamedi a.s.e ka përdor këtë fjalë në disa raste.Ai ka thënë : Sehabët e mi=shokët e mi ose shoku im.Por siç e thash më sipër është më mirë sot për shumë arsye të përdorim shprehjen e bukur “I nderumi filan dhe e nderumja filane”

në vend të fjalës i Zoti, përdorni fjalën i aftë,ndërsa fjalën i del Zot e stagfirullah ta zevevendësoni me fjalën e marr përsipër i del ose i dal në ballë ose në krye kësaj gjëje,fjalën e Zotëron ta zevendësoni me fjalën e përvetëson ose e përvetësoj këtë gjë ose e sundoj atë gjë.Ata njerëz që thonë ne e besojmë se është një Zotë i vetëm xh.sh.është Allahu xh.sh.dhe i falemi e i lutemi veç Atij .por vazhdojnë ti bëjnë shokë Atij në çdo gjuhë,ata njerëz do të hyjnë pa dyshim në xhehenem.Allahu xh.sh ka thënë Kuran: “ Ve min jukul minhum inni ilahum min dunihij fe dhalike nexhizjhi xheheneme.”=Kush prej tyre [prej krijesave të mia] thotë un jam Zoti dënimi për atë është xhehenemi.S.Enbija.aj.29.E si guxon ti o njeri dhe thua se unë i dal Zot kësaj ose asaj ose atij,ose thua jam Zoti i kësaj ose asaj gjëje ? estagfirullah,estagfirullah. E si pranon ti o besimtar që të thonë të tjerët ty O Zoti filan ose ndryshe Zotni filani? Estagfirullah estagfirullah,estagfirullah.Ndërsa Zoti xh.sh.në Kuran na thotë : “Të mos e konsiderojmë njëri tjetrin zotër përveç Allahut xh.sh”S.Ali Imran.aj.64.Allahu xh.sh.thotë: “Hel taëlemu lehu semijjen? =A di ti për mua [o besimtarë] ndonjë emnak=adash? S.Merjem.aj.65.Adashë qunen dy vetë me të njëjtin emër.Pra nuk duhet të thirret e dhe Allahu xh.sh. që shtë

krijusi e dhe njeriu që është krijesa e Tij me të njëjtin emër. Këtë gjë nuk e pranon edhe llogjika. Mos flisni ju o besimtarë si dexhalat = mashtrusat e mëdhenj. Sot është koha e Dexhalit. Kjo është sprova e madhe për besimtarët e Zotit xh.sh. Sot është koha që dallohen besimtarët e mire, besimtarët e vërtetë të cilët nuk flasin fjalë kufri siç duan dexhalat tu thuash atyre. Daxhali është çdo njeri që nuk ka asgjë të mirë por qindë për qindë i ka veset të këqia. Dexhalat janë ateista. Ata nuk besonjë në Zotin dhe në botën tjetër pas vdekjes - në ringjalljen. Ata përpiqen vetëm për të jetuar mirë në këtë botë. Ata janë pa vlere morale, janë mashtusa të mëdhej, hileqarë, lakmiqarë, tradhëtar, ngatërrestarë e gënjeshtarë të mëdhenj. Ata janë pa mëshirë dhe nuk mbajnë drejtësi. Ata janë të pa ngopur me pasuri dhe përpiqen me të gjitha mjetet që kanë në dorë për ti përçarë njerëzit duke i zhvshur ata krejtësisht nga çdo lloj vlere morale që njerëzit mos të jenë të bashkuar. Qëllimi i tyre është që ti komandojnë kollaj popujt për të siguruar sundimin e tyre të përhershëm. Profeti Muhamed a.s. ka thënë: “Në ymetin tim do të dalin tridhjetë dexhala të mëdhej [teoricienë - mashtusa të mëdhej].” Trans. Muslimi. Fatkeqësisht sot njerëzit dexhala janë me mira e miliona në faqen e tokës dhe janë në çdo vend të botës. Dexhalat e kanë sot në dorën e tyre pothuajse në çdo shtet pasurinë dhe fuqinë = pushtetin dhe ekonominë. Qëllimi kryesorë i tyre është prishja e moralit të njerëzve në gjithë botën. Dexhalat që janë më të fuqishëm fusin grindje e ngrehin luftra të mëdhaja mes popujve. Cdo gjë e keqe vjen prej tyre. Unë shkruesi i librit kam ndigjuar se ata njerëz që i thonë vetes kristianë, dexhalit ose njeriut dexhal i thonë “Anti Krishti” Sot fatkeqësisht shumica e parisë fetare kudo në botë kanë devijuar nga e vërteta për shumë çështje të fesë siç është çështja e shirkut të madh në çdo gjuhë dhe çështja e dexhalit. Një pjesë nga këta nuk e kanë të qartë. Ndërsa pjesa tjetër nga këta janë të shitur. Kur i pyet populli i pa ditur se qysh është çështja e shirkut gjuhësorë dhe kush është dexhali ata i rrejnë besimtarët e sinqertë duke ju thënë nuk është

ashtu. Ata i japin kuptim tjetër fjalëve të Kuranit e haditheve të Pejgamberit a.s. për interesat e tyre dhe të atyre që i kanë vënë në detyrë. Ata nuk e pranojnë të vërtetën kur ju thotë dikush nga besimtarët e sinqertë se me atë emër që thirret në atë gjuhë Allahu xh.sh. nuk duhet me thirr njeriun dhe se dexhali ka dalë dhe po sundo në gjith botën. Ndërsa pariya fetare e prishur ju thonë njerëzve : E dijmë ne këtë gjë. Mos i besoni askujtë pa u këshilluar me ne. Përgjigjësja e tyre është e afërt me fjlët që ju tha dikurë Firauni njerëzve në Misir=Egjipt kështu: “A po besoni ju para se tu jap unë leje juve ? “=A po i besoni ju fjalëve të Musait pa më pyet mua= para se tu jap unë leje juve ?

Dhe që e kishim fjalën tek shirku Allahu xh.sh. ka lajmëruar në Kuran se shirkun nuk ia fal askujt ndërsa të tjerat ia fal kujt të dojë. Gjithashtu o beimtar nuk lejohet ta thërrasësh njeriun me tituj të mëdhej që indirektë nënkuptohet Allahu xh.sh. si përshembull; Iplotëfuqishëm, Mbreti i gjithësisë, I lartë madhërushëm ose Lartëmadhëri. Edhe këto tituj nuk i lejon feja Islame për njerëzit. Pejgamberi a.s. e ka ndaluar që të respektohet njeriu me këto tituj të mëdhej se janë cilësi posaçme të Allahut xh.sh. që është Krijusi i Gjithësisë. Dhe që e kishim më sipër fjalën për Mevludin, duhet ditur se nuk mjafton si shprehje dashurije ndaj Pejgamberit a.s. vetëm gëzimi për lindjen e tij, këndimi i mevludit, dëgjimi, këndimi i kasideve ose i ilahive me të cilat lavdrohet Pejgamberi a.s. por dashurija më e madhe për Pejgamberin a.s. është që muslimanët të ndjekin rrugën e tij. Të njohin sa më mirë jetën e Tij; veprimet e mësimet e Tij dhe ti zbatojnë ata në jetën e tyre të përditshme. Allahu xh.sh. në Kuran thotë : “Ju e keni shembullin më të mirë ke i dërguari i Allahut [në veprimet e tij] ai [njeri] që ka shpresë në shpërblimin e Allahut në botën tjetër, ai që atë shpresë e shoqëron duke përmendur Allahun [duke fal namazë, duke bërë zikër, duke ju lutur Atij e duke zbatuar urdhërat e Allahut]. S. Ahzab. aj. 21. Edhe nga pamja e jashtëme trupore Pejgamberi a.s. ka qenë njeriu më i

bukur. Ai ndriste si dritë nga bukurija e hijeshija që kishte. Hazreti Aisheja r.t.a. ka thënë : “ Kur e panë gratë e Misirit [sot Egjpti] Hazreti Jusufin a.s. të veshur me rroba të mira ata i prenë gishtat e duarvet duke qeruar mollët, ndërsa po ta shikonin të dërguarin e Allhut xh.sh. Muhamedin a.s. do të prisnin zemrat.” Aisheja r.t.a. ka treguar kështu: “ Nga ndriçimi i fytyrës së Muhamedit a.s. unë e fusja penin në vrimën e gjilpërës natën kur ai e afronte fytyrën pranë.” Ndërsa dijetari dhe shkrintari i asaj kohe Hasan Thabiti ka thënë: “Ma të hijshëm se ti nuk kanë pa sytë e mi, më të bukur se ti nuk kanë lindur gratë ndonjë fëmij. Ti je në trup pa asnjë të metë ashtu deshi e të krijoj Zotit i vërtetë.”

Fund

Rastet kur mund të këndohet Mevludi

Mevludi këndohet kryesisht në hënën e vet= në hënën Rebiul-Evel por Mevludin mund ta këndosh edhe në këto raste: 1-Kur lind fëmia i parë, 2-Kur bën djemtë suynet; 3-Kur hyn në shtëpin e re, 4-Kur dikush nga antarët e familjes është larguar nga shtëpia shumë kohë dhe kthehet përsëri pas disa vitesh shëndoshë e mire, 5-Nëse ban fejesa e martesë, 6-Pas shpëtimit nga ndonjë rrezik ose fatkeqësi e madhe. 7-Këndohet Mevluludi dhe në raste vdekjesh. Në rastë vdekje duhet të këndohet pjesa e parë e Mevludit ku aty tregohen cilëstë e Zotit xh.sh. e pastaj këndohen pjesët tjera që kanë lidhje me vdekjen siç janë Ndërrimi i jetës së Pejgamberit a.s. dhe hallet e vdekjes. Në se koha është e kufizuar pjesën që tregon ndërrimin e jetës së Pejgamberit a.s. mundet ta fillosh tek pjesa e dytë që fillon me fjalët: “Me pikëllim vdekjen e Pejgamberit ta ndigjojmë” Në të gjitha këto raste nëse bën gosti duke bërë dreka ose darka për miqtë e shokët bëhuni o besimtarë shkaktarë që duke kënduar Mevlud të mblidhen njerzit për të kujtuar e lavdruar Allahun xh.sh. dhe për të nderuar e

përshëndetur me selam të dërgurin e Tij, Pejgamberin a.s.e gjithashtu për të ndigjuar këshilla e për të marrë mësim nga hoxhallarët për fenë Islame. Nëse veproni kështu keni sevape, keni vepruar mirë dhe do të shpërbleheni prej Allahut xh.sh. në dynja dhe në ahiret. Në qoftë se i mblidhni njerëzit për ti kënaqur me harame me muzikë e raki atëherë mjer për ty o i mjeri njeri. Ti bën kot harxhim dhe nga Zoti xh. merr dënim. Shtruarja e gostis me ushqim hallal është veprim i pejgamberëve paçin selam dhe synet i Pejgamberit tonë a.s. Allahu xh.sh. përmend në Kuran gostin që shtroi për mysafirët e tij hazreti Ibrahim i a.s. Gjithashtu Pejgamberi ynë hazreti Muhamedi a.s. ka shtruar gosti për miqtë e shokët e tij. Përsa i takon gostis në ditën e vdekjes nuk është e lejuar nga feja Islame pamvarsishtë se njerzit sot shtrojnë drekë për fisin, miqtë e shokët e njeriut të vdekur. Kjo gjë është gabim. Atë ditë familjarët e njeriut që ka vdekur janë të dëshpruar prej ndarjes nga kjo jetë të njeriut të tyre. Dikur kur në vendin tone nuk kishte mjete komunikacioni familjarët e njeriut që kishte vdekur shtronin pak bukë të thjeshtë për fisin e miqtë e largët sa për të pasur fuqi ata për të ecur dhe këtë bukë të thjeshtë e bënin komshijtë e të vdekurit vetëm për ata që vinin nga larg. Populli i thoshte asaj bukë gjunjësh=sa me zën urinë. Ndërsa sot njerzit po shtrojnë gosti në vdekje si me qenë gosti dasme.. Kjo është gabim është e ndaluar nga ana fetare se është harxhim i tepërt që nuk duhet.. Për sa i takon mbajtjes së ditëve të zisë ose ditëve për ngushullime ato mbahen 3 ditë.. Nuk lejohet ndryshimi i veshjes me rroba të zeza në rastë vdekje se kjo gjë quhet protestë e heshtur kundër Allahut xh.sh. i cili solli vdekjen. Pejgamberi a.s. ka thënë: ‘Veshja krejtësishtë me rroba të zeza nuk është për ne muslimanët.’ Gjithashtu nuk lejohen nga feja Islame bërtitjet, çirret dhe vajtimi me gojë në formë kënge për të vdekurin. Pejgamberi a.s. ka thënë: ‘Një nga zakonet e qafirave është vajtimi me gojë për të vdekurin.’ Ai ka thënë: ‘E qara me lot për të vdekurin është rrahmanij-është mirë se ajo vjen nga

mëshira.”Për sa i takon kujtimit të vdekjes Pejgamberi a.s.ka thënë: ‘Kujtonja shpesh vdekjen se ky kujtim ju largon nga punët e këqia se ju përkujton ahiretin=(gjygin e llogarisë).”Ndërsa për të vdekurit Pejgamberi a.s. ka thënë: ‘Kujtoni të mirat që ka bërë i vdekuri e jo të këqiat që mund të ketë bërë ai.’Për sa i takon njeriut të vdekur Pejgamberi a.s. ka thënë: ‘Jepni sadaka dhe lutjuni Allahut xh.sh.për të vdekurin.”Dijetarët e parë Islam duke u nisur nga Kurani që është fjala e Allahut zxh.sh.dhe nga hadithet fjalët e Pejgamberit a.s.kanë thënë që sevapet ose ndryshe mirësitë e njeriut të gjallë që është besimtarë arrijnë tek i vdekuri besimtarë.Sevapet që përfiton i vdekuri nga i gjalli janë këto:1-Sadakaja ose ndryshe lëmosha që jepet për shpirtin e të vdekurit nga fisi,të afërmit,miqtë dhe shokët e tij,2-Këndimi i Kuranit dhe lutja që i bëhet Allahut xh.sh.për atë njeri,3-Nëse i vdekuri ka lënë prapa ndonjë vepër të mirë që njerzit kanë mirësi prej asajë si përshembull:Ka ndërtuar një xhami,ka bërë një çezëm,një rrugë,një urë,ka shkruar ndonjë libër,ka ndërtuar ndonjë spital,ka lënë ndonjë vend vakuf, ka mbjellë pemë ose ka lë prapa vetes ndonjë fëmij besimtarë që i lutet Zotit xh.sh.për prindërin e tij.Nga të gjitha këto që përmenda e të tjera vepra të mira të ngjajshme me këto përfiton i vdekuri sevape e shpërblime në botën tjetër pas vdekjes,derisa këto vepra të jenë në faqen e tokës.Për sevapet që përfiton i vdekuri besimtarë nga i gjalli dhe mos përfitimin e atij njeriu që nuk ka qenë besimtar na e tregon qartë Kurani i cili thotë: ‘Dhe asnjërit prej atyre që mohuan Allahun dhe të dërguarin e Tij dhe vdiqën kryeneçë (të pa bindur për besim),mos ia fal namazin (e xhenazes) kurrë e as mos qëndro pranë varrit të tij=(për këndim Kurani e lutje për të).”Sure.Tobe.ajeti.84.Nga ky ajet Kurani mësojmë 3 gjëra.1 Duhet të ja falim namazin e xhenazes atij njeriu që ka qenë besimtarë,pasi nuk kemi dëgjuar se ai e ka mohuar Allahun xh.sh.dhe të dërguarin e Tij Pejgamberin Muhamedin a.s. 2-Pas faljes së namazit duhet të qëndrojmë pranë varrit të vdekurit për

të iu lutur Allahut xh.sh. duke kënduar Kuran. Duhet ta dini se surja Fatiha është pjesë Kurani dhe quhet suretu dua=Kapitulli i lutjes ose koka e lutjeve. Pejgamberi a.s. ka thënë: ‘Surja Fatiha është përmbledhësja e gjithë duave=e gjithë lutjeve. Po kështu nga ajetet lutje ose ndryshe dua të Kuranit janë dhe këto ajete: Rrab-benagfiri velivalidejje ve lil muëminine jevme jekumul hisab. Rrab-bena in-nena amena fagfirlena ve kina adhaben-nar’ Këto ajete janë lutje por njëkohësisht janë pjesë Kurani. E pra qëndrimi tek varri i besimtarit për lutje për të cilin na urdhëron Allahu xh.sh. në suren Tobe që treguam më sipër ka për qëllim pa dyshim këndimin e Kuranit e lutjeve nga Kurani. 3-Mësojmë se nuk duhet të ia falim namazin e xhenazes dhe as ti lutemi Zotit xh.sh. për atë njeri që ne e kemi dëgjuar ose e kemi kuptuar mirë nga fjalët dhe veprat që ka bërë se ai njeri kur ishte i gjallë nuk ishte besimtar e kishte mohuar Zotin xh.sh. dhe të dërguarin e Tij Pejgamberin a.s. Për këndimin e Kuranit të vdekurve Pejgamberi a.s. ka thënë: ;Këndonja të vdekurve tuaj suren Jsin.’ E transmetojnë këtë hadithë: 1-Imam Ahmedi, 2-Ebu Daudi, 3-Ibni Maxhe, 4-Nisaiu, 5-Imami Tirmidhiu, 6-Ibni Hibani, 7-Dari Kutniu, 8-dhe Ederamiju në musnedin e tij nga Ebu Hurejre. Gjithashtu Pejgamberi a.s. ka thënë : ‘Këdoni suren Jasin edhe atij njeriu që është duke dorzuar shpirtin=që është duke vdekur se e lehtësoni në dashtë Allahu xh.sh. Këtë hadithë e transmeton Ibni Kethiri në faqen 581 nga Dari Kutuniu. Të vdekurit secili nga ne duhet ti këndojmë vazhdimishtë por sidomos të paktën më e fundit mos ti harrojmë në ditën e xhuma, në muajin e Ramazanit e sidomos natën e Kadrit, në dy darkat e bajramevet, në natat mëdhaja ose ndryshe i quajm natat e mira, natën e arefatit ose darkën e Haxhijvet, në natën e dhjetë të hënës Muharrem dhe në natën e Mevludit=në natën e 12 ose gjatë ditëve të tjera të kësaj hane. Pasi të vdesi njeriu është mir ai që do nga të afërmit e të vdekurit ti këndoi atij 52 ditë çdo natë suren Jasin duke filluar që nga dita e varrimit ose le ti bëjë nëse ka mundësi në ditën e

varrimit një hatme Kurani.Në se nuk ka mundësi atë ditë për ti bërë Hatme le të ja bëjë më prapa.Kur i vdekuri mbush 52 ditë që ka vdekur i këndohet Kuranë për shpirtin e tij ose më mirë nëse i ke pëgaditur një hatme Kurani dhe pas këndimit të Mevludit i bëhet duaja e 52 ditëve.Eshtë thënë në libra të ndryshëm nga dijetarët musliman siç është libri Mesh-hur se kur njeriu i mbush 52 ditë që ka vdekur atëherë i ndahet mishi nga kockat dhe ndjen shpirti dhimbje e dëshprim ashtu sikurse i gjalli që friksohet e dëshprohet në ëndërr kur sheh gjëra të frikshme.Në krye të 52 ditëve i këndohet duaja që është e caktuar për këtë gjë të cilën e kemi shkruar më poshtë.Këndimin e hatmes=e gjithë Kuranit ose të disa pjesëve të tij dhe duan e 52 ditëve ja bën vetë njeriut tëndë të vdekur nëse din ose përndryshe porosit për këtë gjë ata që dijnë.Për këta gjëra që tham më sipër duhet të shpërblehen ata njerëz që merren me këta punë se ata harxhojnë kohën e lodhen për ti bërë keto veprime.Prinjësit e muslimanëve Imam Shafiu dhe Imamë Maliku kan thënë se lejohet të merret shpërblim për këndimin e Kuranit për të gjallët e për të vdekurit= Për mësimin e Kuanit të tjerëve dhe për të sëmuret e të vdekurit.Pejgamberi a.s. ka thënë: “Kale in-ne ehaka ma ehadhtum exhren kitabullah”=Që do të thotë: Pagesa që e merrni me të drejtë është ajo e librit të Allahut.[xh.sh.].Transmeton hadithin Hadimiju.volumi 2.nr.124-125.Në hytben,ligjëratën ose fjalimin e fundit para popullit Pejgamberi a.s.ju tha atyre: O ymeti im ju porosis për ti dashur e ti respektoni Hafizat e Kuranit edhe dijetarët.Nëse nuk do të paguheshin dijetarët e fesë atëherë kush do ta përhapte dijen e fesë në popull ? Allahu xh.sh.thotë në Kuran: “Cka do që të jepni nga pasuria e keni për veten tuaj,por mos jepni për tjetër gjë por vetëm për hater të Allahut dhe çfar do që tu jepni të tjerëve nga pasuria ajo do tu kompensohet [do tu shpërblehet] në mynyr të plotë duke mos u dëmtuar ju. [Jepni] për të varfërit që janë angazhuar në rrugën e Allahut [në rrugën e fesë=në mësimin e fesë] dhe nuk kanë mundësi të lëvizin nëpër

tokë [për tu marrë me tregti,zejtari=profesione e bujqësi]...S.Bekare.aj.272-273.Vërtetë dijetarët ose hoxhallarët nuk kanë qenë e nuk janë të pasur me përjashtim të ndonjë rasti të rrallë për arsye se ata nuk kanë mundësi të merren as me tregti e as me bujqësi e profesion.Sasia e shpërblimit për ata që merren me shërbimet fetare personale të njerëzve nuk ka caktim të prerë.Secilit nga njerzit i ka dhën Allahu xh.sh.mendjen për gjykim. Secili nga besimtarët le ta çmojë vetë punën e hoxhës=mësusit të fesë.Dhe që e kishim fjalën më sipër për të vdekurit nëse mbledh njerëz pas 52 ditëve për të bër dua për të afërmin tëndë të vdekur fiton sevape i vdekuri por dhe i gjalli që bëhet shkatarrë për një veprim të tillë të mirë se jua kujton vdekjen njerëzve të gjallë dhe përfitojnë ata nga këshillat fetare prej dijetarëve të fesë.Pejgamberi a.s. ka thënë: ‘Kur njerzit mblidhen në një vend së bashku dhe kujtojnë=ose përmendin Allahun xh.sh.Ai i shikon me mëshir ata njerëz,dhe nëse njerzit mblidhen në një vendë dhe aty nuk përmendet Allahu xh.sh.(por bëhen biseda të kota) Allahu xh.sh.nuk i mëshiron ata njerëz.Ata njerëz kur ngrihen nga vendi ku janë ulur lënë prapa një erë të keqe si era e ngordhsinës.’ Nëse i mbledh njerzit për muhabet=sa për tu dukur atëherë ke bërë një veprim të kotë.Prej këtij veprimi nuk ka mirëresi i vdekuri.Eshtë krejtësishtë harxhim i kotë, është veprim i pa dobishëm për veten tënde dhe për njerzit tjerë që vinë tek ti për ngushullim.Ky veprim është jo vetëm i pa dobishëm por dhe i dëmshëm pasi gjatë bisedave aty njerzit merren me thash e theme duke marr nepër gojë=duke ofenduar e duke akuzuar njerzit tjerë të ndryshëm që nuk gjinden aty.Kjo gjë është e ndaluar nga feja Islame=është haram..

Përgaditi
Haxhi Ymer Aga
Imami i xhamisë Farkë-Tiranë-2013

DUAJA E 52 DITEVE

Kjo dua këndohet shtatë herë

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ بِحَقِّ حَقِّكَ، وَبِحَقِّ كِبَرِيَّاتِكَ وَبِحَقِّ جَمَالِكَ وَجَلَالِكَ وَبِحَقِّ
وَجُودِكَ وَقَضَائِكَ وَكَرَمِكَ يَا قَدِيمَ الْإِحْسَانِ يَا صَادِقَ الْوَعْدِ الْأَمِينِ • لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ
سُبْحَانَكَ إِنِّي كُنْتُ مِنَ الظَّالِمِينَ • اللَّهُمَّ اجِبْ دَعْوَتِي بِحُرْمَةِ إِسْمِكَ الْعَظِيمِ وَبِحُرْمَةِ
مُحَمَّدٍ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ وَعَلَى آلِهِ وَصَحْبِهِ أَجْمَعِينَ، وَالْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ، وَلَا
وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ الْعَلِيِّ الْعَظِيمِ • هُوَ الْبَاقِي

Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahijm

All-llahume inni ves-se'luke bihaki hakike, ve bihaki kibrijaike, ve bihaki xhemalike ve xhelalike, ve bihaki uxhudike ve fadlike ve keramike. Ja kadimel-ihsane, ja sadikul-vadel-emijn. La ilahe ila ente, subhaneke inni kuntu minedh-dhalimijn. All-llahume exhib daaveti bihurmeti ismikel-adhim, ve bihurmeti Muhamedin sal-lall-llahu teala alejhi ves-selem, ve ala ehlihi ve sahabihi exhmeijn. Ve-lhamdul-lil-lahi rabil-alemin, ve la havle ve la kuvete ila bil-lahi alij-jil adhim.

DUAJA E SYNETLLIKUT

El-hamdulilahil-ledhij xheale min sherafil islam hitamel evladi ves-salatu ues-selamu ala Resulina Muhamedinish- shefi'i li ehliis-sun'neti jeumil miaadi ve ala aalihi ve ashabihi as'habel hajril iëtijadi ves-selamun alel murselin uel-hamdulil-lahi rab-bil aalemijn lilahi elfatiha.

E bëra synet meshkujt është porosi e Pejgamberit a.s.Mosha e më e mirë për tu bërë synet është nga dita e shtatë e lindjes e deri në moshën dhjetë vjeçare.E bëra synet fëmijët ka shumë të mira.Eëmijët i mbron nga sëmundjet e ndryshme se i mbron nga mikropet.Para se të bëhet synet fëmija duhet të lahet krejtësisht që të jetë i pastër nga çdo mikrop dhe të lahet me nijetin për synetllik.

Në fillim këndohet pak Kuran e pastaj bëhet duaja.

Duaja e synetllikut bëhet para se me fillu berberi për ta bërë synet fëmijën. Personi që bën duanë dhe të tjerë që ndodhen aty ngrejne duart dhe bëjnë duanë mësipërme.)

DUAJA E MARTESES KUR VIHET KUNORA BISMIL-LAHI RRAHMANI-RRAHIM

All-lahumexh-al,hadhel,akde,mejmunen
mubareken,vexh,al,bejnehuma,ulfeten,ve muhab-beten vela texh-
al bejnehuma nefreten ve firara All-llahum-me el-lif bejnehuma
kema el-lefte bejne Aademe ve Havva ve kema el-lefte bejne
Muhammedin ve Hatixhetel kubra radiall-llahu anhuma. All-
llahum-me eati lehuma evladen saliha ve umren tavilen ve riskan
vasia. Rab-bena heblena min ezvaxhin ve dhurrij-jatina kurrete
aëjunin vexh-alna lil myt-tekine imama. Subhane rrab-bike rrab-
bil izeti am-ma jessifune ve slamun alel murselin vel hamdul lil
lahi rrab-bil aalemijn. Lil lahi el Fatiha.

RREGULLAT PËR DUAN E MARTESES DUAJA E MARTESES, KUR VIHET KUNORA BISMIL- LAHI RRAHMANIRR-RRAHIM

Kur t'i vihet kunora çiftit duhet të plotësojë kushte: 1.Pëlqimi me dëshirë i djalit dhe vajzës njëri tjetrin. 2.Mosha e pjekurisë 3.Dëshmitarët për futjen e kunorës e cila duhet të bëhet me dua. Në fejesë dhe në martesë imami i xhamisë- hoxha duhet të thirret

për vënien e kunorës çiftit të ri. Vënja e kunorës është urdhëri i Zotit dhe syneti i Pejgamberit. Në duanë e martesës merren dy dëshmitarë për nusen dhe dy për burrin. Në fillim këndohen pjesë nga Kurani që kanë lidhje me martesën. Për shembull këndohen ajetet **32-33** të sures Nur ose mjafton sureja Fatiha dhe surja Ihlas tre herë ai që nuk i di ajetet e mësipërme. Para se të bëhet duaja pyeten nusja dhe dhëndërrri dhe dy dëshmitarët e burrit dhe dy dëshmitarët e gruas duke ju drejtuar kështu: Me urdhërin e Zotit (xh.sh), me synetin e Pejgamberit a.s. dhe me ixhtihadin e Ebu Hanifes (imami Azem-Adham); Ti filan i biri i filanit dhe filanes,-A je dakort që filani të lidhi kunorë (të martohet) me filanen të bijën e filanit dhe të filanes? Pasi të marri vërtetimin me gojë "Po" nga tre herë për secilin, po kështu iu drejtohet dhe dëshmitarëve të vajzës ose nuses. Pyetja bëhet që ata ta dinë mirë që vajza dhe djali nuk janë fis me njëri-tjetrin se martesa brenda fisit është e ndaluar nga Allahu xh.sh. Këtë gjë e tregon qartë Kurani. Lidhja ndërmjet çiftit të jetë me sinqeritet dhe jo për qëllime të liga. Nëse dëshmitarët e dijnë se çifti=vajza e djali martohen me njëri tjetrin me qëllim jo të sinqertë atëherë dëshmitarët kanë përgjegjësi para Allahut xh.sh.

Nuk lejohet martesa e vajzës me një burrë pa dëshirën e saj dhe nuk lejohet të martohet vajza pa pëlqimin e prindërve të saj ose të atyre që përgjigjen për atë sepse përndryshe martesa nuk është e rregullt. Pejgamberi ka thënë: "Martesa pa praninë e prindërit ose të atij që kujdeset për vajzën nuk është e rregullt." Trans. Muslimi.

Vajza dhe djali nuk lejohet të rrinë dhe të dalin sëbashku pa bërë lidhjen e kurorës(cilibrimin) me Kur'an dhe dëshmitarë. Fëmijët që lindin pa lidhur kunorë quhen të pa ligjshëm nga ana fetare islame. Pejgamberi ka thënë: "Kur Allahu e krijoi Havanë, Ademi zgjati dorën që ta ledhatonte, por meleku Xhebrail e ndaloi duke i thënë, akoma nuk ta kemi lidhur kurorën". Trasmeton Muslimi. Prandaj sipas fjalës së pejgamberit (a,s) nuk lejohet vajza dhe djali të rrinë e shëtisin së bashku pa bërë lidhjen

e kunorës. Lidhja e kunorës është e detyrueshme se e verteton Kur'ani famëlartë.

Allahu xh.sh thotë në *Kuran në* suren Bekare: “ Dhe mos vendosni lidhjen e kunorës para se të vië afati i caktuar...”

DUAJA E TARAVIVET

Elhamdu lil lahi rrab -bil aalemin,ves-salatu ves-selamu ala resulina Muhamedin ve ala alihij Vesahbihi ve ehlibejtihi exhmein.All-llahume rab-bena ja rab-bena tekab-bel min-na salatet taravihi bi hurmeti shehri Ramadan ve bi hurmeti nebij-jina Muhamedin fij ahiriz - zaman ve bihurmeti Teurati vez-Zeburi vel Inxhili vel Kuran, fi hil bereketu vel gufran ve nexhaten minen niran, ve minel adhabil elvan bi rahmetike ja errhamerr-rrahimijn ; Ja Han-nan, ja Men-nan,ja Dej-jan.

Merhaben ja shehre Ramadan.All-llahum-me rrab-bena tekab-bel min-na salatet taravihi ve duaena ve xhealenahu makbuleten ve latured-du mean naksan birahmetike ja erhamerr-rrahimijn ves selamun alel murselijn vel hamdu-lil-lahi rrab-bil aalemijn.

Kjo dua këndohet kur mbaron falja e namazit të taravivet. Imami kthehet me fytyrën karshi xhematit, ndërsa muezini thotë:Eudhu bil-lahi minesh-shejtani rraxhim-Bismil-lahi Rrahmani-Rrahimj dhe këndon këtë ajet nga Kurani: “Ve ma erselnake il-la rahmete lil aalemijn.” Pastaj të gjithë i ngrejnë duart me shuplakat nga qielli dhe imami bën me zë të ngritur duan e namazit të taravivet që shënuam sipër dhe xhemati thonë amin secili në çdo ndalesë që bën imami.

Përgaditi: Haxhi Ymer Aga, Farkë-Tiranë. 2013.

Përmbajtja e lëndës

- 1-Parathënja
- 2-Ajete nga Kurani që këndohen gjatë këndimit të Mevludit.
- 3-Mevludi Sherif=Lindja e Pejgamberit a.s.
- 4-Miraxhi i Pejgamberit a.s.
- 5-Ndërrimi i jetës së Pejgamberit a.s.
- 6-Lutja ose duaja e Mevludit.
- 7-Mevludi prej Hafiz Abdullah Zemblakut {i përmbledhur.
- 8-Hallet e vdekjes.
- 9- Argumentat e dijetarëve Islam për Mevludin.
- 10- Rastet kur këndohet Mevludi
- 11- Duaja e 52 Ditëvet që bëhet për të vdekurin
- 12- Duaja e synetllikut
- 13- Duaja e Martesës
- 14- Duaja e Taravivet